



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)

Raporti i Sistemeve Hidro-Mekanike





Shtator, 2024

KONSULENTI:



Porositësi:	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)
Titulli i Dokumentit:	Raporti i Sistemeve Hidro-Mekanike
Faza e Projektit:	Projekt Për Leje
Kodi i dokumentit:	ICE-360-P07-V01

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për projekt teknik		18/09/2024

	KONSULENTI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Kontrolloi:	Miratoi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri: Firma:	Marsel Pylla Silvja Gjonaj  Anxhela Bici  Artjola Zotaj 	Besnik KARAJ Olset HAXHIU 			
Data:	16/09/2024	18/09/2024	18/09/2024		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2024

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	4
2 Kriteret e përgjithshme të zgjedhjes së impianteve mekanike	5
3 IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJË SANITAR	6
3.1 TË PËRGJITHSHME	6
3.2 KONCEPTIMI I SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË.....	6
3.3 PËRMASIMI I RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË UJIT TË FTOHTË SANITAR	7
3.4 REZERVA UJORE	12
3.5 GRUPI I NGRITJES MEKANIKE.....	12
4 IMPIANTI I SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA DHE ATMOSFERIKE	13
4.1 TË PËRGJITHSHME	13
4.2 KONCEPTIMI I SISTEMIT TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA	13
4.3 PËRMASIMI I RRJETIT TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA	14
4.4 PËRMASIMI I SISTEMIT TE SHKARKIMIT TE UJËRAVE ATMOSFERIKE	18
4.4.1 Konceptimi i Sistemit të Shkarkimit të Ujërave Atmosferike.....	18
4.4.2 Përmasimi i Sistemit te Shkarkimit te Ujerave Atmosferike.....	18
5 Sipërfaqet që do të drenazhohen nga piletat rrethore:	19
6 UJITJA E SIPËRFAQEVE TË GJELBËRUARA.....	21
6.1 Standardet dhe Manualët	21
6.2 Nevoja e Bimëve Për Ujë.....	21
6.3 Llogaritja dhe Rezultatet e Sasisë se Ujit te Nevojshëm	22
7 SISTEMI I NGROHJES, FRESKIMIT DHE VENTILIMIT	24
7.1 Baza normative.....	24
7.2 Përshkrim i përgjithshëm i objektit.....	24
7.3 Konditat projektuese.....	24
7.4 Llogaritjet termike	26
7.5 Sistemi i perzgjedhur	26
7.6 Përshkrimi i sistemit te perzgjedhur	26
7.7 Funkionimi i Sistemit	27
7.7.1 Ngrohja/Ftohja Hidronike	27
7.7.2 Ventilimi me Ajër të Pastër	27
7.8 Specifikimet teknike	27
7.9 Konsideratat e Efikasitetit	27
7.10 Metoda e Kontrollit për Përdorimin Ditor	28
7.10.1 Sistemi i Menaxhimit të Ndërtesës (BMS).....	28
7.11 Konkluzion	28

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1 Prurjeve Totale për Nyjen Sanitare ne dhomat e hotelit	8
Tabela 2-2 Prurjeve Totale për katin nentoke te hotelit.....	8
Tabela 2-3 Shpejtësitë maksimale të lejuara të lëvizjes së ujit në sistemin hidrosanitar sipas diametrave të linjave	9
Tabela 2-5 Njësitë e Shkarkimit dhe Diametrat Minimalë të Shkarkimit të Pajisjeve	15
Tabela 2-6 Kolonat e Shkarkimit	16
Tabela 2-7 Përmasimi I Kolektorëve.....	17

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Vendndodhja e objektit	4
Figura 2-1 Skema e Lidhjes me Sistemin e Furnizimit me Ujë	6
Figura 2-2 Rrjeti Shperndares me Sistem Kolektoresh.....	7
Figura 2-3 Planimetria e Nyjes Sanitare.....	10
Figura 2-4 Prurja LLogaritëse Q_{liog} (l/s) në Funkcion të Prurjes Totale Q_t në Njëk.....	11
Figura 2-5 Skema e Furnizimit me Ujë të Objektivit.....	11
Figura 2-6: Planimetria e Shkarkimit te Ujerave te Ndotura ne Nje Nyje Sanitare.....	15
Figura 2-7: Aksonometria e Sistemit te Shkarkimit të ujërave të Ndotura	16
Figura 2-8: Plani i Kullimit të Taracës se hotelit dhe parkimit	18

1 HYRJE

Shoqëria "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) në cilësinë e Zhvilluesit, kontratën me objekt: Projekti teknik për "Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)".

Raporti paraqet llogaritjet hidraulike të projektit të ndërtesave të parkimit të automjeteve dhe hotelit të cilat ndodhen siç tregohet më poshtë (në kuadratin me të verdhë):




Figura 1-1: Vendndodhja e objektit

Projekti përbëhet nga dy ndërtesa me pesë kate mbi tokë dhe një kat nëntokë. Ndërtesa e parë do të shërbejë si parkim për automjetet me një volum 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë. Kjo ndërtesë do të lidhet me ndërtesën e re të mjekësisë së përgjithshme dhe ndërtesën kryesore të urgjencës. Ndërtesa e parkimit pozicionohet në hyrjen kryesore të QSUT-së, në perëndim të ndërtesës ekzistuese të urgjencës. Ndërtesa e dytë do të jetë hotel dhe pozicionohet në veri të ndërtesës së parkimit e ndarë me një fugë 15 cm. Kjo ndërtesë ka 5 kate mbi tokë për shërbimet e pritjes dhe të logjistikës dhe 1 kat nëntokë që do të shërbejë për ambiente teknike në funksion të hotelit.

2 KRITERET E PERGJITHSHME TË ZGJEDHJES SË IMPIANTEVE MEKANIKE

Ne menyre qe te kuptohet sa me thjeshte zgjedhja impiantistike e aplikuar ne projektet mekanike, ne vazhdim jane paraqitur kriteret kryesore te pershtatura ne projekt. Zgjidhja e pergjithshme ne projektet mekanike eshte mbeshtetur ne arritjen e nje sistemi teknik dhe teknologjik te pergjithshem me efikasitet te larte, duke pershtatur arkitekturen e objektit, duke respektuar normat teknike, duke siguruar konsumet energjitike minimale si dhe duke respektuar normat e ndotjes ambientale.

Ne vazhdim po paraqesim kriteret kryesore baze te aplikuar ne projekt:

- Konfort maksimal ne perdorim
- Besueshmeri maksimale
- Inspektim te parametrave dhe impianteve
- Siguri dhe higjene e garantuar ne perdorim
- Parcializim ne perdorimin e impianteve
- Kursim energjistik maksimal
- Respektimi i normave te ndotjes ambientale dhe te ambientit
- Kosto te ulta ne ndertim
- Kosto te ulta ne perdorim
- Standartizim te komponenteve per lehtesi te mirembajtjes

Projektet e impianteve mekanike janë mbështetur në normat teknike SSH EN 806, SSH EN 12056, SSH EN 752 dhe Rregullore Teknike në Projektim dhe Ndërtim “RT 2018 – Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimi, Pjesa 1&2”.Projektet e impianteve mekanike persa ka qene e mundur jane mbeshtetur ne normat teknike Shqiptare dhe europiane.

3 IMPIANTI I FURNIZIMIT ME UJË SANITAR

3.1 TË PËRGJITHSHME

Sistemi i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë në të gjithë godinën, pavarësisht ndarjeve dhe destinacionit të ambienteve të brendshme. Nevojat e përgjithshme për ujë pavarësisht përdorimit dhe përpunimit të tij llogariten në bazë të kërkesave të konsumatorëve dhe normave teknike projektuese. Impianti i furnizimit me ujë sanitar të ftohtë do të përbëhet nga:

- 1- Rrjeti i shpërndarjes (kollonat e furnizimit).
- 2- Rezervuari i ujit.
- 3- Grupi i Ngritjes Mekanike (Stacioni i pompave).

3.2 KONCEPTIMI I SISTEMIT TË FURNIZIMIT ME UJË

Sistemi i furnizimit me ujë të ndërtesës është sistem i degëzuar me presion, i projektuar të furnizohet me ujë nga rrjeti shpërndarës, por i mundësuar të furnizohet edhe me ngritje mekanike me anë të një grupi presioni i furnizuar nga një depozitë uji, si by-pass i tubacionit kryesor nga pika e lidhjes me rrjetin shpërndarës, nëse rrjeti shpërndarës nuk do të furnizojë prurjen e kërkuar me presionin e nevojshëm, në çdo orë të ditë-natës (24 orëshit).

Pjesët përbërëse të Impiantit të furnizimit me uje sanitar janë si më poshtë:

- a) Linja e lidhjes së sistemit hidrosanitar të furnizimit me ujë me rrjetin shpërndarës të ujësjellësit dhe kutia e ujëmatësit me elementët përbërës të tij. Kjo linjë, e cila quhet edhe tubacioni kryesor (apo edhe magjistrali) i sistemit hidrosanitar, përbëhet nga pika e shpimit të tubacionit kryesor bashkë me saraçineskën përkatëse (saraçineska mund të vendoset edhe para kutisë së aparatit ujëmatës), nga tubacioni lidhës dhe nga kutia e aparatit ujëmatës të përbashkët me elementët përbërës të tij. Pika e lidhjes me sistemin e furnizimit me ujë të ndërtesës do të caktohet pasi të kryhen analizat përkatëse të cilësisë së ujit në pikën e lidhjes dhe të merret miratimi nga institucioni përkatës, për përdorimin e ujit. Analizat e cilësisë së ujit duhet të kryhen para fillimit të punimeve, në institucionin përkatës shëndetësor, përgjegjës për cilësinë e ujit për përdorime sanitare ose ujëpirje në zonën ku ndodhet ndërtesa.




Figura 2-1 Skema e Lidhjes me Sistemin e Furnizimit me Ujë

- b) Sistemi hidrosanitar i shpërndarjes së ujit të ftohtë nga pika e lidhjes deri tek nyja sanitare më e largët, në katin më të lartë përbëhet nga elementët e mëposhtëm:
- Tubacioni kryesor i furnizimit (i futur minimalisht 1 m nën tokë për të siguruar mosngrirjen) me ujë nga pika e lidhjes me magjistralin deri tek aparati ujëmatës dhe në vazhdim deri tek depozita dhe sistemi i ngritjes mekanike. Aparati ujëmatës përbëhet nga kutia e cila vendoset në mur ose në tokë, ujëmatësi, saraçineska kryesore, filtri mekanik, reduktori i presioni dhe kundralvola, të gjitha prej bronzi, me bashkim me mbërthim (të filetuara dhe lidhen me niples ose me mbërthim F-M) dhe për presion pune PN 20 bar.
 - Tubacioni shpërndarës i cili fillon nga sistemi i ngritjes mekanike, ose në rastet kur nuk është e nevojshme ritja e presionit nga aparati ujëmatës deri tek kolonat e furnizimit ose kolektorët. Këto tubacione do të montohen në shtresat e dyshemesë së katit përdhe ose nën tavanin e katit nëntokë, si dhe në muret e hapësirave të përbashkëta (korridoret, kafazet e shkallëve, etj.).
- c) Tubacionet vertikale të kolonave të furnizimit me ujë të ftohtë të cilat bëjnë shpërndarjen vertikalisht në secilin kat të ndërtesës.
- d) Tubacionet shpërndarëse të ujit nga kolonat deri tek kolektorët dhe më pas deri tek pajisjet hidrosanitare brenda nyjeve sanitare. Këto linja do të trasohen në dyshemenë e katit përkatës deri në hyrje të nyjeve sanitare. Brenda nyjes sanitare do të shtrohen në dysheme deri tek muri ku montohet pajisja hidrosanitare dhe do të trasohet edhe brenda murit në drejtimin vertikal deri në lartësinë e daljes së ujit sipas skedës teknike të pajisjes. Elementët e tjerë që vendosen janë shpërndarësit (kolektorët) prej bronzi si dhe materialet e lidhjeve të pajisjeve me sistemin e FU, si minisaraçineskat, etj.




Figura 2-2 Rrjeti Shpërndarës me Sistem Kolektorësh

3.3 PËRMASIMI I RRJETIT TË SHPËRNDARJES SË UJIT TË FTOHTË SANITAR

Projektimi i sistemit hidrosanitar të furnizimit me ujë të pijshëm të ndërtesës është kryer sipas hapave të mëposhtëm:

- a) Planimetria: Vizatimi i gjurmëve të linjave të furnizimit me ujë nga pika e lidhjes në katin përdhe e deri tek pajisjet hidrosanitare të ndërtesës. Gjurmët e tubacioneve, pozicioni i kolonës (-ave) të furnizimit me ujë dhe pikat ujëdhënëse vizatohen në planimetrinë e çdo kati dhe të nyjeve sanitare të ndërtesës. Vizatohen tubacionet dhe pajisjet e tjera në dhomën teknike të ndërtesës (kati nëntokë ose mjedis tjetër i përshtatshëm).
- b) Skema aksonometrike: Vizatimi i skemës aksonometrike e sistemit ose skemës vertikale (principale) të kolonës(-ave) të furnizimit me ujë (nëse nevojiten), sipas një dimetri të caktuar. Në skemë paraqiten edhe elementët e veçantë si, saraçineskat kryesore, ujëmatësit, reduktorët, filtrat, kundralvolat, pompat apo edhe depozitat e magazinimit të ujit, etj.

- c) Prurjet llogaritëse: Ndarja dhe emërtimi i sistemit hidrosanitar në pjesë llogaritëse të sistemit duke u bazuar në planimetrinë dhe në skemën aksonometrike (apo principale) të sistemit të furnizimit me ujë. Gjendet numri dhe lloji i pajisjeve hidrosanitare, të furnizuara nga çdo pjesë llogaritëse e këtij sistemi dhe duke pasur parasysh parametrat hidraulike të pajisjeve, gjenden prurjet totale dhe llogaritëse të ujit në çdo pjesë llogaritëse Bazuar në numrin dhe llojin e çdo pajisjeje hidrosanitare si dhe në prurjen nominale të secilës prej tyre, gjendet prurja totale dhe më pas prurja llogaritëse e çdo pjese duke konsideruar njëkohshmërinë e funksionimit të pajisjeve hidrosanitare në çdo kategori ndërtese.

Projektimi i sistemit të furnizimit me ujë brenda ndërtesave është bërë në përputhje me:

- SSH EN 806 Specifikime për instalimet brënda ndërtesave për transportin e ujit për përdorim njerëzor.

Permasimi i tubacioneve të furnizimit me ujë është filluar nga nyja sanitare me më shumë aparate hidrosanitare. Dhe për secilin nga këto aparate sanitare përcaktohen diametrat e tubacioneve që duhet të vijjnë nga kolektori. Dhe më pas diametri i tubacionit nga kolona e furnizimit me ujë tek kolektori i nyjes sanitare. Dimensionimi është bazuar në prurjet totale të kërkuara nga aparatet hidrosanitare si dhe në respektimin e shpejtësive maksimale (1.0 m/s tub ϕ 16mm; 1.1 m/s tub ϕ 20mm; 1.3 m/s tub ϕ 25mm; 1.6 m/s tub ϕ 32mm dhe 1.8 m/s tub ϕ 40mm).

Mëposhte jepet planimetria e nyjes sanitare dhe tabela e prurjeve totale të tubave që lidhen me kolektorin:

Tabela 2-1 Prurjeve Totale për Nyjen Sanitare ne dhomat e hotelit

Nr	Emërtimi i Pajisjeve Hidrosanitare	Prurja Specifike Uji i Ftohte (l/s)	Prurja Specifike Uji i Ngrohte (l/s)	Njësia Ekuivalente (NjEk)	Presioni I Punës (m)
1	Larëse Duarsh – LD	0.1	0.1	1	5
2	Klozetë me kasetë – WC	0.1	-	1	5
6	Grup Dushi – DU	0.2	-	2	5
	Prurje max	0.2	0.2	2	
	Prurja Totale	0.6	0.3	6	

Tabela 2-2 Prurjeve Totale për katin nentoke te hotelit

Nr	Emërtimi i Pajisjeve Hidrosanitare	Prurja Specifike Uji i Ftohte (l/s)	Prurja Specifike Uji i Ngrohte (l/s)	Njësia Ekuivalente (NjEk)	Presioni I Punës (m)
1	Larëse Duarsh – LD	0.1	0.1	1	5
2	Klozetë me kasetë – WC	0.1	-	1	5
3	Larëse Pjatesh - LP	0.2	0.2	2	5
4	Larëse Automatike Rrobash – LR	0.1	-	2	5
5	Larëse Automatike Enësh - LE	0.2	-	2	5
	Prurje max	0.2	0.2	2	
	Prurja Totale	0.7	0.3	8	

- d) Përmasimi i elementëve të sistemit dhe humbjet hidraulike. Përmasat e elementëve të sistemit janë gjetur sipas shprehjes $d = f(q_{llog}, vek)$ duke u bazuar në tabelën nr. 4 të shpejtësive maksimale të lejuara dhe në grafikët e mëposhtëm të dhëna për secilin material të tubacionit dhe për temperaturat përkatëse të ujit në pjesët e sistemit në llogaritje.

Në grafikët e mëposhtëm gjenden edhe pjerrësitë hidraulike (humbjet hidraulike të presionit për çdo metër gjatësi të tubit) të energjisë hidraulike (presionit) në çdo pjesë të sistemit $ph = f(q_{llog}, d, vek)$, dhe në llogaritjet sipas tabelës nr. 5 gjenden humbjet hidraulike gjatësore në secilën pjesë

Ilogaritëse të sistemit . Shpejtësia e rekomanduar gjendet në intervalin midis shpejtësisë minimale $V_{min} = 0.50 \div 0.75$ [m/sek] dhe shpejtësive maksimale për çdo diametër, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2-3 Shpejtësitë maksimale të lejuara të lëvizjes së ujit në sistemin hidrosanitar sipas diametrave të linjave

Shpejtësitë maksimale të lejuara (V_{maks})	
Tub plastik (PP-R, PE, PE-Xa)	
Diametri D_j [mm]	Shpejtësia V_{maks} [m/sek]
deri 25	1.2
32	1.3
40	1.6
50	2.0
63	2.1
75	2.3
90 e sipër	2.5

- **Lidhja midis kolektorit dhe aparateve hidrosanitare ne dhomat e hotelit:**

Për shperndarjen e ujit të ftohte dhe të ngrohtë nga kolektori tek pajisjet hidrosanitare është përdorur tub PEX-Al-PEX $\phi_e 16 \times 2.0$ mm i cili siguron nje prurje max deri ne 0.4 l/s. Ndërsa përsa i përket tubit te ujit të ngrohte që lidhet nga rrjeti kryesor i sistemit me uje të ngrohtë deri te kolektori do të përdoret tub PEX-Al-PEX $\phi_e 16 \times 2.0$ mm i cili siguron nje prurje max deri ne 0.7 l/s.

- **Lidhja midis kolonës dhe kolektorit:**

Përsa i përket tubacionit nga kolona e furnizimit me ujë deri tek kolektori është përdorur tub PPR me diametra nga ($\phi_e 20 \times 3.4$ - $\phi_e 32 \times 5.4$) mm i cili siguron nje prurje max deri në 1.3 l/s.




Figura 2-3 Planimetria e Nyjes Sanitare

- Rrjeti Kryesor i Shterndarjes (kolonat):

Përsa i përket dimensionimit të rrjetit kryesor të shterndarjes dhe kolonave, tubacionet dimensionohen në baze të prurjes llogaritëse Q_{llog}. Prurja llogaritëse Q_{llog} përcaktohet me anë të grafikut të mëposhtëm.




Figura 2-4 Prurja Llogaritëse Q_{llog} (l/s) në Funkcion të Prurjes Totale Q_t në NjEk

- 1- Prurja Llogaritëse Q_{llog} (l/s)
- 2- Prurja Totale Q_t në Njësi Ekuivalente (NjEk)
- 3- Vlera më e lartë e Njesisë Ekuivalente të pajisjes hidrosanitare

Në baze të skemes së furnizimit me ujë të objektit (shih figurën mëposhtë) janë përcaktuar prurjet llogaritëse të secilit segment.




Figura 2-5 Skema e Furnizimit me Ujë të Objektit

Për segmentin A-B, për NjEK max të një aparati hidrosanitar NjEKmax=2 dhe prurje totale NjEKtot=4, prurja llogaritese është Qllog=0.2 l/s. Për segmentin B-C, për NjEK max të një aparati hidrosanitar NjEKmax=2 dhe prurje totale NjEKtot=10, prurja llogaritese është Qllog=0.47 l/s.

Për segmentin A-B është zgjedhur tubi PP-R me $\phi 20 \times 3.4$ mm, për prurjen 0.3 l/s (Segmenti A-B) shpejtësia është 0.8 m/s dhe humbjet hidraulike janë 0.05 m/m. Ndërsa për segmentin B-C është zgjedhur tubi PP-R me $\phi 25 \times 4.2$ mm, për prurjen 0.47 l/s (Segmenti B-C) shpejtësia është 1.3 m/s dhe humbjet hidraulike janë 0.11 m/m

3.4 REZERVA UJORE

Sasia e kërkuar që do të shërbejë si rezervë ujore vetëm për impiantin e furnizimit me ujë sanitar është në varësi të kërkesave të konsumatorëve në përputhje me destinacionet e ambienteve të brendshme.

Ndërtesa e hotelit përbëhet nga 6 kate. Për këtë ndërtesë është bere llogaritja mbi bazen e numrit te shtreterve, te cilet jane parashikuar te jene 120 copë. Norma ditore e rezervës së ujit e llogaritur për klientët është 200 litra dhe për restorantet 20 l/s për vakt. Sasia e ujit rezervë e nevojitur për 24 orë është 20-25 m³. Kjo sasi uji rezervohet në një depozitë 65 m³.

3.5 GRUPI I NGRITJES MEKANIKE

Grupi i ngritjes mekanike (pompa) është llogaritur në bazë të kërkesave të konsumatorëve si dhe vlerave të presionit në përputhje me lartësinë e ambienteve të cilave u shërbejnë. Kështu grupi i ngritjes mekanike për impiantin e furnizimit me ujë sanitar do të përbëhet nga dy pompa inverter.

Prurja e nevojshme e llogaritur për furnizimin me ujë të ambienteve të banimit është marë si shumatorja fundore e secilës kolonë furnizimi. Kjo prurje rezulton afersisht 0.86 l/s.

Percaktimi i presionit normal të ngritjes mekanike bëhet duke llogaritur të gjitha presionet e nevojshme tek pajisjet hidrosanitare dhe humbjet hidraulike në rrjetin e shpërndarjes.

Presioni normal që duhet të sigurojë sistemi i ngritjes mekanike përbëhet nga:

Δh - disnivele midis pikes së furnizimit dhe pajisjes hidrosanitare më të larget.

P_{min} - presioni minimal i nevojshem për aparatin hidrosanitar

H_{app} - humbjet e presionit në rrjetin e furnizimit

F- 0.45, koeficienti që mer parasysh humbjet e vendit (në kthesa, saracineska, brryla etj.)

Mëposhte jepet llogaritja e presionit normal që duhet të siguroje sistemi i ngritjes mekanike.

4 IMPIANTI I SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA DHE ATMOSFERIKE

4.1 TË PËRGJITHSHME

Impianti i shkarkimit të ujërave të ndotura shërben për mbledhjen e shkarkimeve të ambienteve të tilla si: nyje sanitare, kuzhina, lavanteri si dhe mbledhjen/disiplinimin e ujërave të shiut.

Ky impiant do të projektohet duke u mbështetur mbi të gjitha normat në fuqi. Impianti i Shkarkimit do të ndahet në disa sisteme si më poshte:

- Sistemi i shkarkimit të ujërave të zeza (që do të shërbejë për shkarkimin e të gjitha njeve sanitare).
- Sistemi i shkarkimit të ujërave të shiut.

4.2 KONCEPTIMI I SISTEMIT TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura të ndërtesës është sistem me vetërrjedhje nga pajisjet hidrosanitare e deri tek puseta e lidhjes me rrjetin e oborrit.

Sistemi hidrosanitar i kanalizimeve të ujërave të ndotura të ndërtesës përbëhet nga pjesët përbërëse si më poshtë:

- a) Tubacionet e degëzimeve të cilat mbledhin dërgojnë ujërat e pajisjeve hidrosanitare tek kolona. Këto tubacione duhet të trasohen në brendësi të murit pas pajisjes (pjesa vertikale e tyre) dhe në dyshemenë e nyjes sanitare me pjerrësinë mininale $p_{min} = 0.02$ m/m (shih tabelat më poshtë). Lartësia minimale e shtresave për trasimin e tubacioneve duhet të jetë $15 \div 20$ cm (ose soleta e nyjes sanitare të jetë e thelluar $10 \div 15$ cm dhe shtresat të jenë $5 \div 10$ cm). Bashkimi i tubacioneve në planin horizontal të jetë me kënd 45° dhe nuk lejohet bashkimi në një pikë i dy linjave që vijnë nga drejtime të kundërta (nuk lejohet lidhja me dopiobragë në planin horizontal). Tubacionet me drejtim pingul me tubacionin ku do dërgojnë ujërat e ndotura do të lidhen me bragë me kënd 45° dhe bërryl me kënd 45° . Tubacionet duhet të fiksohen me fasheta metalike (me gomina brenda tyre) në dyshemenë apo muret e nyjes sanitare, për të mos lejuar lëvizjen e tyre pas montimit.
- b) Tubacioni vertikal i kolonës së shkarkimit të ujërave të ndotura, i cili do të largojë ujërat e ndotura nga tubat e degëzimeve të njeve sanitare, në tubin përkatës të derdhjes në katin nëntokë apo nën dyshemenë e katit përdhe. Kolona do të montohet në pusët teknike përkatëse dhe do të kapet në strukturë me fasheta metalike fikse dhe orientuese (jo të shtrënguara). Fashetat metalike të jenë me gomina unazore brenda tyre për lidhjen sa më të mirë me tubacionin dhe për të shmangur transmetimin e vibrimeve nga kolona tek struktura. Lidhja e tubave të degëzimeve tek kolona të bëhet me braga SOVENT, ose në mungesë të tyre edhe me braga me kënd 45° dhe me bërryl me kënd 45° . Kolonat duhet të dalin në tarracën e ndërtesës me lartësi $70 \div 100$ cm mbi nivelin e shtresës më të sipërme të mbulesës së tarracës (shih vizatimet). Shmangiet e kolonave nga vertikalisiteti të bëhen me kënde 45° si në vizatime. Të vendosen pikat e kontrollit në pozicionet e përcaktuara tek vizatimet dhe sidomos në vendet e veçanta, si para shmangjes nga vertikalisiteti të kolonës në katet e ndryshme si dhe në fund të saj. Lidhja e kolonës me tubin e derdhjes të realizohet gjithnjë me dy kthesa (bërryla) me kënd 45° dhe me largësi të kthesave nga njëra tjetra rreth $L = 2 \times D_j$ [mm] të kolonës.
- c) Tubat e derdhjes apo kolektorët, të cilët janë të lidhura me kolonat si në vizatime do të trasohen nën dyshemenë e katit përdhe ose nën tavanin e katit nëntokë (apo të katit përdhe), me pjerrësi $p_{min} = 0.02$ m/m, si në vizatime (nuk lejohen ndryshime të trasimit të tyre, pa miratimin me shkrim të supervisorit apo edhe projektuesit). Në pozicionet e parashikuara në projekt dhe para kthesave apo bashkimeve të tubave të derdhjes të vendosen pika kontrolli siç jepen në vizatime. Linjat e rrjetit

të oborrit të kanalizimeve të ujërave të ndotura ne rastet kur nuk ka sistem kanalizimesh te ujerave te ndotura te qytetit ose fshatit do te shkarkohen ne gropen septike.

- d) Linjat e rrjetit të oborrit të kanalizimeve të ujërave të ndotura nga puseta e lidhjes me sistemin hidrosanitar të shkarkimit të ujërave të ndotura, deri tek puseta e lidhjes me rrjetin rrugor të kanalizimeve të ujërave të ndotura të qendrës së banuar, sipas lejes së dhënë nga ndërmarrja e UKT. Kjo linjë përbëhet nga pusetat e lidhjeve, tubacionet dhe nga pusetat e kthesave apo të bashkimeve të tubacioneve, si në vizatime. Tubacionet e kanalizimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të klasës SN4 dhe/ose SN8, siç jepen në vizatime duhet të vendosen në thellësi minimale rreth $H = 0.7 + Dj$ [m], në zonën e këmbësorëve dhe rreth $H = 1.0 + Dj$ [m], në zonën e mjeteve motorike. Pusetat e lidhjes, bashkimit dhe të kontrollit të tubacioneve të ujërave të ndotura do të jenë prej betoni të armuar të klasës C25/30, me çimento antisulfate, me mure me trashësi minimale $t = 20$ cm dhe me kapak gize të klasës EN 124 D400, për pusetat në rrugën e mjeteve motorike, EN 124 C250, për pusetat në sheshin e parkimit dhe EN 124 B125, për pusetat në zonën e gjelbër dhe të gjitha llojet e sipërppërmendura do të jenë me hyrje DN 600 ÷ 620 mm. Pusetat janë parashikuar të jenë të betonuara në vend me përmasa si në vizatimet (hollësitë strukturore të shikohen tek projekti konstruktiv).

4.3 PËRMASIMI I RRJETIT TË SHKARKIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Projektimi i sistemit të shkarkimit të ujërave të ndotura brenda ndërtesave është bërë në përputhje me:

SSH EN 12056 Sistemet e shkarkimit me gravitet brenda ndërtesave.

Duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

Planimetria:

Pozicionimi i kolonës (-ave) të shkarkimit brenda puseve teknike të dhëna në projektin arkitektonik të ndërtesës. Pozicionimi i pajisjeve hidrosanitare është si në projektin arkitektonik, por në përputhje me kushtet e funksionimit të SKUN/hs (sipas së cilës klozeta rekomandohet të jetë afër kolonës së shkarkimit). Përcaktohet gjithashtu tipologjia e sistemit të shkarkimit, e cila do të jetë:

- me ajrim direkt, në rast se disniveli i lidhjes më të lartë në kolonë me tubin e derdhjes është ≤ 10 m (shih vizatimet);
- Me ajrim paralel, në rast se disniveli i lidhjes më të lartë në kolonë me tubin e derdhjes është > 10 m (shih vizatimet, skemat sipas standardit EN 12056);

Vizatimi i gjurmëve të linjave të shkarkimit të ujit nga pajisjet hidrosanitare të çdo nyjeje sanitare deri tek kolona përkatëse e shkarkimit. Pas kësaj vizatohen gjurmët e tubave të derdhjes (kolektorët), nën tavanin e katit nëntokë ose nën dyshemenë e katit përdhe të ndërtesës, duke filluar nga kolonat e deri tek pozicioni i pusëtës përkatëse të lidhjes me rrjetin e mbledhjes së ujërave të ndërtesës.

Skema aksonometrike:

Vizatimi i skemës aksonometrike e sistemit ose skemës vertikale (principale) të kolonës(-ave) të kanalizimit të ujërave të ndotura (nëse nevojiten), sipas një dimetrie të caktuar. Në skemë paraqiten edhe elementët e veçantë, si pikat e kontrollit dhe pastrimit, sifonet apo kundra valvolat përkatëse, si dhe puseta e lidhjes me rrjetin e mbledhjes së ujërave.

Prurjet llogaritëse:

Ndarja dhe emërtimi i sistemit hidrosanitar të KUN në pjesë llogaritëse të sistemit duke u bazuar në planimetrinë dhe në skemën aksonometrike (apo principale) të këtij sistemi. Gjendet numri dhe lloji i pajisjeve hidrosanitare, të cilat shkarkojnë ujërat në çdo pjesë llogaritëse të sistemit dhe duke pasur parasysh parametrat hidraulike të pajisjeve, gjenden prurjet totale dhe llogaritëse të ujit në çdo pjesë

llogaritëse. Bazuar në numrin dhe llojin e çdo pajisjeje hidrosanitare si dhe në prurjen nominale të secilës prej tyre, gjendet prurja totale dhe më pas prurja llogaritëse e çdo pjese me anën e tabelave ose edhe të formulave të mëposhtme, të ndara sipas kategorive të ndërtesave. Prurja llogaritëse e tubit të derdhjes që lidhet me pusetën e rrjetit të oborrit është prurja llogaritëse e shkarkimit të ujerave të ndotura (UN).

Përmasimi i tubacioneve të nyjeve sanitare:

Përmasimi i tubacioneve të shkarkimit të ujerave të ndotura ka filluar me nyjet sanitare, bazuar në prurjet e shkarkimit të secilit aparat hidrosanitar. Mëposhtë jepet planimetria e nyjes sanitare dhe tabela përmbledhëse me diametrat e tubave të shkarkimit për secilin aparat hidrosanitar.




Figura 2-6: Planimetria e Shkarkimit të Ujerave të Ndotura në Një Nyje Sanitare

Tabela 2-4 Njësitë e Shkarkimit dhe Diametrat Minimalë të Shkarkimit të Pajisjeve

Nr	Emërtimi i Pajisjeve Hidrosanitare	Njësia e Shkarkimit (NjShk) l/s	Diametri Minimal Dj (mm)	Pjerrësia minimale ρ_{min} (m/m)	Pjerrësia normale ρ_n (m/m)
1	Larëse Duarsh – LD	0.5	40	0.02	0.035
3	Bide – BD	0.5	40	0.02	0.035
4	Klozetë me kasetë – WC	2.5	90÷110	0.012	0.02
7	Pllakë Dushi – DU	0.6	50	0.02	0.035
8	Larëse Pjatashtash – LP	0.8	50	0.02	0.035
9	Larëse Automatikë Rrobash – LR	1.0	50	0.01	0.02
10	Larëse Automatikë Enësh - LE	0.8	50	0.01	0.02
11	Pisuar - P	0.5	40	0.02	0.035
12	Piletë Dyshemeje DN 50 ÷ 63 mm	0.8	50÷63	0.02	0.035
13	Piletë Dyshemeje DN 75 mm	1.5	75	0.02	0.035
14	Piletë Dyshemeje DN 90 ÷ 110 mm	2.0	90÷110	0.012	0.02

Përmasimi i kolonave të shkarkimit:

Pasi janë dimensionuar tubacionet e nyjeve sanitare dhe janë përcaktuar kolonat ku do të shkarkojë secila prej tyre. Përcaktohet diametri i kolonave duke pasur parasysh konceptin e njëkohshmërisë së funksionimit të pajisjeve hidrosanitare që shkarkojnë NjShk tek tubi përkatës i derdhjes.

Prurja llogaritëse për përdorim të njëkohshëm llogaritet me formulën:

$$q_{llog} = 0.7 \cdot \sqrt{q_{tot}}$$

Prurjet llogaritëse për secilin kolonë tregohen në figurën mëposhtë.




Figura 2-7: Aksonometria e Sistemit të Shkarkimit të ujërave të Ndotura

Në varësi të prurjeve të llogaritura për çdo kolonë bëhet dhe dimensionimi i tyre duke përdorur tabelën mëposhtë:

Tabela 2-5 Kolonat e Shkarkimit

Prurjet në Kolonat e Shkarkimit			
Kolonat e Shkarkimit me Ajrim Direkt		Kolonat e Shkarkimit me Ajrim Paralel	
Kolona e Shkarkimit Dj (mm)	Prurja Q_{llog} (l/s)	Kolona e Shkarkimit (tubi paralel i ajrimit) Dj (mm)	Prurja Q_{llog} (l/s)
63	0.7	63(50)	0.9
75	2.0	75(50)	2.6
90	3.5	90(63)	4.6
110	5.2	110(75)	7.3
125	7.6	125(90)	10.0
160	12.4	160(110)	18.3
200	21.0	200(110)	27.3

Përmasimi i kolektorëve:

Mbas përmasimit të kolonave të shkarkimit dimensionohen kolektorët të cilët mund të mbledhin ujërat e disa kolonave. Kolektorët lidhen me pusetat e oborrit.

Dimensionimi i kolektorëve bëhet në varësi të prurjeve llogaritëse, të treguara në skemën aksonometrike (figura mësipër). Dhe në varësi të kësaj prurje dhe pjerrësisë së shtrimit të tubacionit përcaktohet dhe diametri. Diametrat e kolektorëve do të përcaktohen duke përdorur tabelën më poshtë:

Tabela 2-6 Përmasimi I Kolektorëve

Kapaciteti i tubave në nyjet sanitare në varësi të pjerrësisë dhe diametrit					
Dj (mm)	0.005	0.01	0.015	0.02	0.025
40	0.11	0.15	0.19	0.22	0.24
50	0.21	0.3	0.37	0.43	0.48
63	0.43	0.61	0.75	0.87	0.98
75	0.72	1.03	1.26	1.46	1.64
90	1.05	1.53	1.88	2.18	2.44
110	1.95	2.79	3.42	3.96	4.43
125	2.85	4.05	4.97	5.75	6.43
160	5.7	8.23	10.1	11.68	13.07

Për përmasimin e tubacioneve duhet të kihet parasysh se lartësia e mbushjes së tubacioneve rekomandohet si më poshtë:

- për tubat e degëzimeve brenda nyjes sanitare (tubat e lidhjes dhe të dërgimit): $h = 0.5 D$
- për tubat e derdhjes (kolektorët) brenda ndërtesës: $h = 0.6 \div 0.7 D$
- për tubat e derdhjes (kolektorët) jashtë ndërtesës deri tek puseta e lidhjes, $h = 0.8 D$.

Shpejtësia rrjedhjes së ujërave të ndotura për përmasimin e tubacioneve të linjave duhet të jetë brenda intervalit të mëposhtëm:

$$v_{\min} = 0.5 \div 0.75 \text{ m/sek} < v_{\text{rek}} < v_{\text{maks}} = 1.5 \div 2.0 \text{ m/sek (brenda ndërtesës)}$$

$$v_{\min} = 0.5 \div 0.75 \text{ m/sek} < v_{\text{rek}} < v_{\text{maks}} = 3.0 \div 3.5 \text{ m/sek (jashtë ndërtesës)}$$

4.4 PËRMASIMI I SISTEMIT TE SHKARKIMIT TE UJERAVE ATMOSFERIKE

Zgjidhja e përgjithshme e projektit është mbështetur në arritjen e një sistemi teknik dhe teknologjik të përgjithshëm dhe efikas, duke përshtatur maksimalisht arkitekturën e objektit, duke respektuar normat teknike, duke siguruar konsumet energjitike minimale si dhe duke respektuar normat e ndotjes ambientale.

4.4.1 Konceptimi i Sistemit të Shkarkimit të Ujërave Atmosferike

Ky sistem shërben për shkarkimin e ujërave të shiut të mbledhur nga taraca e objektit.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të shiut fillon me rrjetin e kullimit të çatisë e cila mbledh të gjitha ujërat e shiut që mund të akumulohet taraca. Këto ujëra që akumulohen kapen nga piletat e vendosura përgjatë pjesës fundore të taraces dhe shkarkohen në kolonat vertikale. Nga kolonat vertikale të shiut ujërat shkarkohen në pusetat pikësore dhe më pas në rrjetin e drenazhimit të oborrit dhe më pas në kolektorin kryesor ose në rrjedhën sipërfaqësore më të afërt.

4.4.2 Përmasimi i Sistemit te Shkarkimit te Ujerave Atmosferike

Projektimi i sistemit të shkarkimit të ujërave atmosferike është përdorur:

- SSH EN 12056 Pjesa 3 - Drenazhimi me gravitet brenda ndërtesave

Për përmasimin e sistemit të drenazhimit të taraces , fillimisht do të përcaktohet intensiteti i shiut për periudhën e përsëritjes së zgjedhur. intensiteti i rënies së shirave, i cili është marrë nga Buletini i Institutit Hidrometeorologjik, 1985, dhe është pranuar për T = 100 vjet, t = 10 minuta me vlerë $i=114 \text{ mm/orë}$ ose 0.0317 l/s/m^2 .




Figura 2-8: Plani i Kullimit të Taracës se hotelit dhe parkimit

5 SIPËRFAQET QË DO TË DRENAZHohen NGA PILETAT RRETHORE:

Grumbullimi dhe largimi i ujërave të shiut do të bëhet me anë të piletave duke parandaluar përmbytjet dhe dëmtimet strukturore. Ato luajnë një rol thelbësor në sistemin e kullimit të ndërtesës, duke siguruar që uji i shiut të mos grumbullohet dhe të shkaktojë probleme, si infiltrimi i ujit, lagështia, apo dëmtimet e shtresës hidroizoluese.

Piletat e shkarkimit të ujërave të shiut do të jenë vertikale dhe do të vendosen në kolonë.

Kur piletat vendosen në kolonë, dimensionimi i tyre varet nga disa faktorë përveç rrjedhës së ujit, si lartësia e kolonës, materialet e përdorura, dhe kapaciteti i tubit vertikal për të evakuuar ujin. Dimensionet e piletave vertikale mund të kenë kapacitete të mëdha për shkak të shtimit të gravitetit në rrjedhjen e ujit. Kjo do të thotë që për parkimin, rrjedha e ujit mund të rritet me lartësinë.

Procesi për llogaritjen e dimensioneve për piletat:

Në Figurën 2-8 jepet plani i kullimit të Taracës së hotelit dhe parkimit. Taraca ka pjerresi për të ndihmuar në kullimin natyral të ujit siç shikohet dhe në figurë.

Percaktimi si prurjes llogaritesë që mbledh secila sipërfaqe është llogaritur me Metoden Racionale.

Metoda Racionale llogarit, në çfarëdo lloj vendndodhjeje të një baseni ujëmbledhës, vlerën maksimale të prurjes, koeficientin dhe intensitetin mesatar të rreshjeve të shiut për një kohëzgjatje të barabartë me kohën e përqëndrimit (koha që i duhet ujit për të rrjedhur nga pika më e largët e basenit në vendndodhjen që po analizojmë), si funksion të zonës së kullimit.

Formula racionale është e shprehur si më poshtë:

$$Q = \frac{C * I * A}{360} [m^3/sec]$$

ku:

Q – prurja e ujërave të reshjeve atmosferike [m³/sec]

C – koeficienti i rrjedhjes sipërfaqësore, i cili është pranuar C = 0.95, meqenëse sipërfaqja konsiderohet e papërshkueshme.

I – intensiteti i rënies së shirave

Nr. Sip	Sipërfaqja ujembledh ese Ac(m ²)	Koha e perqendrimit Tc (min)	K-Coef. Unit conversion	K-Coef. Unit conversion	Koeficient I kullimit	Intensiteti mesatar I rreshjeve (mm/h)	Prurja (m ³ /s)	Prurja (l/s)	Diametri I piletes mm
Taraca e parkimit									
1	162	10	360	1	0.95	114	48.735	4.874	100
2	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
3	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
4	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
5	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
6	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
7	217	10	360	1	0.95	114	65.281	6.528	100
8	162	10	360	1	0.95	114	48.735	4.874	100
9	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
10	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
11	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
12	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
13	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
14	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
15	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
16	214	10	360	1	0.95	114	64.378	6.438	100
17	214	10	360	1	0.95	114	64.378	6.438	100
18	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
19	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
20	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
21	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
22	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
23	220	10	360	1	0.95	114	66.183	6.618	100
24	214	10	360	1	0.95	114	64.378	6.438	100
25	152	10	360	1	0.95	114	45.727	4.573	100
26	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
27	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
28	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
29	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
30	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
31	215	10	360	1	0.95	114	64.679	6.468	100
32	152	10	360	1	0.95	114	45.727	4.573	100
								202.070	
Taraca e hotelit									
1	135	10	360	1	0.95	114	40.613	4.061	70
2	135	10	360	1	0.95	114	40.613	4.061	70
3	135	10	360	1	0.95	114	40.613	4.061	70
4	135	10	360	1	0.95	114	40.613	4.061	70

6 UJITJA E SIPËRFAQEVE TË GJELBËRUARA

6.1 Standardet dhe Manualet

- KTP 11-78 Llogaritja e Rrjetit të Jashtëm të Furnizimit me Ujë
- FAO Irrigation and Drainage Paper No. 56


6.2 Nevoja e Bimëve Për Ujë

Bimët kane nevojë për ujë për të kryer procesin e transpirimit dhe avullimit.

Rrënjët e bimëve thithin ujin nga toka për tu zhvilluar. Pjesa kryesore e ujit nuk qëndron tek bimët por lëshohet në atmosferë për shkak të avullimit të tij nga bimët si shkak i nxehtësisë. Ky proces quhet transpirimi. Procesi i transpirimit ndodh kryesisht gjatë ditës.

Uji nga një sipërfaqe uji e hapur largohet në formë avujsh në atmosferë gjatë ditës. I njëjti proces ndodh me ujin në sipërfaqen e tokës dhe me ujin në gjetheve të bimëve. Procesi i avullimit të ujit nga sipërfaqja e tokës dhe gjetheve të bimëve quhet evapotranspirim.

Sasia e ujit që nevojitet tek bimët është sasia e transpirimit dhe avullimit e quajtur "evapotranspirim".



Sasia e ujit që nevojitet për bimët përcaktohet si prodhimi i koeficientit të bimësisë (K_c) me evapotranspirimin (E_{t0}).

ET_c – nevoja për ujë (mm/dite)

$$ET_c = ET_0 \cdot K_c \quad (1.1)$$

ET_0 – evapotranspirimi (mm/dite)

K_c – koeficienti i bimëve

Për llogaritjen e Evapotranspirimit ekzistojnë disa metoda, ku mund të përmendim: metoda Blaney-Criddle, metoda Thornthwaite, metoda Quijano, metoda FAO Penman-Monteith etj.

Ekuacioni i përdorur për llogaritjen e "Evapotranspirimit" është Penman-Monteith:

ET_o – evapotranspirimi (mm/dite)

$$ET_o = \frac{0.408 \cdot \Delta(R_n - G) + \gamma \frac{900}{T + 273} u_2 (e_s - e_a)}{\Delta + \gamma(1 + 0.34u_2)}$$

R_n –	rrezatimi neto tek sipërfaqja e bimëve	(MJ m ⁻² dite ⁻¹)
G –	densiteti i fluksit të nxehtësisë së tokës	(MJ m ⁻² dite ⁻¹)
T –	temperatura mesatare ditore	(°C)
u_2 –	shpejtësia e erës në 2 m lartësi	(m/s)
e_s –	presioni i avujve të ujit të ngopur	(kPa)
e_a –	presioni i avujve të ujit	(kPa)
Δ –	pjerrësia e kurbes së avullimit	(kPa °C ⁻¹)
γ –	konstante psikometrike	(kPa °C ⁻¹)

Faktorët meteorologjike të cilët përcaktojnë evapotranspirimin janë parametrat klimatike të cilët sigurojnë energjinë për avullimin. Parametrat kryesore klimatike që merren në konsideratë në ekuacion janë:

- Temperatura maksimale mesatare mujore
- Temperatura minimale mesatare mujore
- Lagështia mesatare relative e ajrit
- Rrezatimi diellor
- Shpejtësia e erës

6.3 Llogaritja dhe Rezultatet e Sasisë së Ujit të Nevojshëm

Metoda e vaditjes me spërkatje dhe pika, përbën sot metodën më të përdorur në frutikulturë, në ortikulturë, në serra dhe fidanishte për të cilat kryesore është kursimi i ujit, kursimi i fuqisë punëtore dhe kostot e sistemit të tokës.

Duke u bazuar nga ato që u paraqiten edhe me sipër është marrë në konsideratë norma:

- sipërfaqet me bar natyral – 4 deri 5 litra / m² / dite
- sipërfaqet me bime të vogla- 4 deri 5 litra / m² / dite
- pemët e reja – 50 deri 100 litra / ujitje

Për një ujitje sa më uniforme sipërfaqja ujitëse është ndarë në linja që do të furnizojnë zona të kontrolluara ujitjeje me sprucator, duke shfrytëzuar dhe sistemimin e sipërfaqes së sheshit.

Kjo ujitje do të realizohet për 3 ore me një normë 5litra/ditë/m² dhe sipërfaqe 1320m², duke patur një kërkesë dirore për uje:

$$q_{sek} = \frac{5 * 1320}{3ore * 60min * 60sek} = 0.61 \text{ l/s}$$

Tubacioni i zgjedhur është PE100 PN16 DN OD 32 mm, DN ID 26 mm

Dimensionimi i tubacionit është bërë duke konsideruar shpejtësinë ekonomike 1-1.5 m/s.

Duke patur kriter prurjen dhe diametrin e zgjedhur mund të gjejme shpejtësinë në sistem:

$$v_{ek} = \frac{Q}{S} = \frac{Q * 4}{\pi D^2} = 1.15 \text{ m/s}$$

Llogaritja e humbjeve është realizuar me formulën e Hazen-Williams:

$$h_w = \frac{10.675 * Q^{1.852}}{C^{1.852} * D^{4.8704}} * L = \frac{10.675 * 0.00061^{1.852}}{150^{1.852} * 0.026^{4.8704}} * 500 = 29 \text{ m}$$

Ku:

- Q-prurja në m³/s
- C-koeficienti i ashpërsisë, për tubat PE meret 150.
- D-Diametri i brendshëm i tubacionit në metra
- L-Gjatësia e tubacionit në metra (L=500m)

Pra që sistemi të arrijë presionin e kërkuar në pikën fundore maksimumi 2bar duhet që në pikën e lidhjes të sigurohet presioni 4.9bar.

7 SISTEMI I NGROHJES, FRESKIMIT DHE VENTILIMIT

7.1 BAZA NORMATIVE

VENDIM Nr. 537, datë 8.7.2020	Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave
EN 832	Ngrohja e ndërtesës – llogaritjet e nevojës për energji
UNI 10375	Metoda e llogaritjes së temperaturës së brendshme të ambienteve
ASHRAE 62.1	Ventilation for Acceptable Indoor Air Quality
EN 13790	Llogaritjet për nervojat e energjisë
EN 10077	Transmetimi termik në komponentet e dritareve
EN 13770	Kembimi i energjisë midis terrenit dhe ndërtesës
UNI 10351	Materialet e konstruksionet – përcjellshmëria termike dhe përkueshmëria ndaj avullimit
UNI 10355	Muret dhe soletat – vlerat e rezistencës termike dhe metodat e llogaritjes
EN 832	Ngrohja e ndërtesës – llogaritjet e nevojës për energji
UNI 10375	Metoda e llogaritjes së temperaturës së brendshme të ambienteve

7.2 PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I OBJEKTIT

Objekti në studim është një godinë me dy seksione, njëri parkimi me disa kate dhe seksioni tjetër me destinacion hotelieri. Objekti dhe secili seksion zhvillohet me 5 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, me destinacione si mëposhte:

Kati -1:	Parkim nëntokësor dhe ambiente ndihmëse hoteli
Kati +0 deri +4:	Parkim i hapur perimetralisht dhe ambiente hotelierie
Taraca:	Ambiente teknik për montimin e makinerive

7.3 KONDITAT PROJEKTUESE

Sistemi i ngrohjes dhe freskimit është projektuar që të garantojë parametrat më të mira të mikroklimës në ambientet e brendshme të godinës në kushtet e temperaturave të jashtme projektuese.

Për çdo rast llogaritja termike për dimensionimin e sistemeve është e domosdoshme dhe lidhet ngushtë edhe me kapacitetet e furnizimit me energji elektrike të godinës:

Parametrat gjeografike dhe klimatike të konsideruar në llogaritjet termike janë:

Pozicioni gjeografik

Vere temperatura : +40°C, lageshtia relative 35 %

Dimer temperatura : -1°C, lageshtia relative 85 %

Parametrat klimaterike

Vere temperatura : +40°C, lageshtia relative 35 %

Dimer temperatura : -1°C, lageshtia relative 85 %

Konditat e brendshme

Referuar standartit EN15251 "Indoor environmental input parameters for design and assessment of energy performance of buildings addressing indoor air quality, thermal environment, lighting and acoustics", vlerat e temperaturave per konditat e brendshme jane

Table A.2 — Examples of recommended design values of the indoor temperature for design of buildings and HVAC systems

Type of building/ space	Category	Operative temperature °C	
		Minimum for heating (winter season), - 1,0 clo	Maximum for cooling (summer season), - 0,5 clo
Residential buildings: living spaces (bed rooms, drawing room, kitchen etc)	I	21,0	25,5
	II	20,0	26,0
Sedentary ~ 1,2 met	III	18,0	27,0
Residential buildings: other spaces: storages, halls, etc)	I	18,0	
	II	16,0	
Standing-walking ~ 1,6 met	III	14,0	

Koeficientet e humbjeve termike

Koeficente e humbjeve termike per fazen e llogaritjeve te përgjithshme paraprake jane marre referuar **Vendim Nr. 537 datë 8.7.2020 " Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave"**. Konkretisht

- muret e jashtme në kontakt me mjedisin e jashtëm: $U = 0.38$ (W/m²K)
- çatia (e pjerrët ose tarracë): $U = 0.35$ (W/m²K)
- soleta e papafingos: $U = 0.38$ (W/m²K)
- dyshe me mbështetur në tokë: $U = 0.5$ (W/m²K)
- komponentët me xham (dritaret me kornizë alumin i izoluar, plastike, druri etj.), në të cilët vlera U për strukturat transparente (dritaret) përfshin xhamin dhe kornizën: $U = 2.00$ (W/m²K)

Vlerat e rrezatimit diellor

Referuar te dhenave nga IHM (Instituti i Hidro-Meteorologjise) dhe AKBN (Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore), zona e marre ne studim profilizohet si Zone Mesdhetare Kodrinore e cila ne kushte te cfaredoshme moti mund te marre mesatarisht rreth 1500kWh rrezatim vjetor ose rreth 6.7 kWh/m² ne dite ne muajin Korrik qe rezulton dhe muaji me nivel me te larte rrezatimi.

Tabela 2. Rrezatimi diellor vjetor (kWh/m² ne dite)

Qytetet	Shkoder	Peshkopi	Tirane	Vlore	Erseke	Sarande
Janar	1.70	1.55	1.80	2.15	1.90	1.90
Shkurt	2.30	2.30	2.50	2.85	2.70	2.40
Mars	3.35	3.25	3.40	3.90	3.40	3.60
Prill	4.50	4.15	4.20	5.00	4.40	4.80
Maj	5.45	5.25	5.55	6.05	5.60	5.80
Qershor	6.10	5.85	6.40	6.80	6.40	6.80
Korrik	6.50	6.25	6.70	7.20	6.80	6.10
Gusht	5.55	5.45	6.05	6.40	5.90	4.80
Shtator	4.45	4.35	4.70	5.15	4.70	3.60
Tetor	2.90	2.90	3.20	3.50	3.10	3.20
Nentor	2.10	1.85	2.15	2.40	2.10	2.10
Dhjetor	1.70	1.50	1.75	1.85	1.80	1.80

Burimi : Instituti i Hidro-Meteorologjise

Niveli i zhurmave

Nivelet e zhurmave maksimale të prodhuara nga impiantet brenda ambienteve percaktohen sipas normes EN16798-1 dhe UNI8199 dhe duhet të jënë brenda parametrave të mëposhtëm.

	Periodo diurno (06.00 – 22.00)	Periodo notturno (22.00 – 06.00)
Limiti assoluti		
I – aree particolarmente protette	50 dB(A)	40 dB(A)
II – aree prevalentemente residenziali	55 dB(A)	45 dB(A)
III – aree di tipo misto	60 dB(A)	50 dB(A)
IV – aree di intensa attività umana	65 dB(A)	55 dB(A)
V – aree prevalentemente industriali	70 dB(A)	60 dB(A)
VI – aree esclusivamente industriali	70 dB(A)	70 dB(A)
Limiti differenziali (*)	≤ 5 dB	≤ 3 dB
(*) non si applicano se - il livello del rumore ambientale misurato a finestre aperte è inferiore a 50 dB(A) durante il periodo diurno e a 40 dB(A) in quello notturno - il livello del rumore ambientale misurato a finestre chiuse è inferiore a 35 dB(A) durante il periodo diurno e a 25 dB(A) in quello notturno		

Tabella 2: DPCM 14/11/1997: Valori limiti assoluti di immissione in funzione della zonizzazione acustica del territorio e valori limite differenziali

Tipologia di Ambiente	Livello di rumore dB(A)		
	I	II	III
Soggiorno	≤ 30	≤ 35	≤ 40
Camera da letto	≤ 25	≤ 30	≤ 35

Tabella 3: Valori massimi di progetto per la rumorosità immessa negli ambienti serviti da sorgenti sonore impiantistiche secondo la norma UNI EN 16798-1

7.4 LLOGARITJET TERMIKE

Per percaktimin e kapaciteteve termike të godines eshte bere nje llogaritje paraprake duke konsideruar koeficientet struktural te cituar me lart dhe pavaresisht kesaj, kapaciteti i njesive te brendshme eshte unifikuar duke konsideruar qe fan coil do te japin kapacitetin e tyre ne shpejtesi te mesme.

Llogaritjet e sakta duhet te behen ne fazen e projektit te zbatimit.

7.5 SISTEMI I PERZGJEDHUR

Projekti është një hotel me 6 kate që përfshin një sistem HVAC hidronik. Sistemi përfshin pompa nxehtësie ajër-ujë të instaluar në tarace, njësi fan coil të shpërndara brenda ndërtesës, dhe njësi trajtimi ajri (AHU) që ofrojnë ventilim me ajër të pastër.

Sistemi është dizajnuar me fokus në efikasitet të lartë energjie, duke përdorur AHU me rikuperim energjie dhe rrotë entalpie. Ky raport përshkruan sistemin e përzgjedhur, mënyrën e funksionimit, përshkrimin e njësive kryesore, specifikimet teknike të pajisjeve dhe materialeve, konsideratat e efikasitetit dhe metodat e kontrollit për përdorimin ditor

7.6 PERSHRKIMI SISTEMIT TE PERZGJEDHUR

Sistemi HVAC bazohet në një konfigurim hidronik ku pompat nxehtësie ajër-ujë gjenerojnë ujë të ngrohtë ose të ftohtë, i cili qarkullon tek njësitë fan coil në të gjithë ndërtesën. Ventilimi i ndërtesës do të bëhet përmes tre njësive trajtimi ajri (AHU):

- Një që shërben dhomat e hotelit,
- Një që shërben restorantin, dhe
- Një për zonat e tjera të shërbimit

AHU janë dizajnuar vetëm për ventilim me ajër të pastër, duke siguruar standardet më të larta për cilësinë e ajrit të brendshëm. Të gjitha njësitë do të jenë të pajisura me rrotë entalpie për rikuperim

energjie, duke minimizuar humbjet energjetike përmes rikuperimit të nxehtësisë dhe lagështisë nga ajri i daljes.

Rrjeti i tubacioneve që shpërndan ujin e ngrohtë dhe të ftohtë do të përbëhet nga tuba çeliku, ndërsa rrjeti i shpërndarjes së ajrit do të jetë i ndërtuar me dukt çeliku të galvanizuar.

7.7 FUNKSIONIMI I SISTEMIT

7.7.1 Ngrohja/Ftohja Hidronike

Pompat nxehtësie ajër-ujë prodhojnë ujë të ngrohtë ose të ftohtë në varësi të sezonit. Ky ujë qarkullon përmes tubave të çelikut tek njësitë fan coil të vendosura në secilën zonë të ndërtesës. Njësitë fan coil më pas shpërndajnë ajrin e kondicionuar në dhoma, duke i ngrohur ose ftohur ato sipas nevojës.

- **Modaliteti i Ngrohjes:** Në dimër, pompat nxehtësie marrin nxehtësi nga ajri i jashtëm, e transferojnë në ujë dhe më pas e qarkullojnë në njësitë fan coil për të ngrohur hapësirat e brendshme.

Modaliteti i Ftohjes: Gjatë verës, pompat nxehtësie marrin nxehtësi nga hapësirat e brendshme dhe e largojnë atë jashtë, duke ftohur ujin dhe duke shpërndarë ajër të freskët në hapësirat përmes njësive fan coil

7.7.2 Ventilimi me Ajër të Pastër

- **AHU për Dhomat e Hotelit:** Ofron ajër të pastër dhe rikuperon energji nga ajri i daljes.
- **AHU për Restorantin dhe zonat e shërbimit:** Siguron normat e larta të ventilimit për hapësirat e ngrënies dhe kuzhinën si dhe mirëmban cilësinë e ajrit të brendshëm në hapësirat ndihmëse si korridoret, hollin dhe zonat për personelin

7.8 SPECIFIKIMET TEKNIKE

Pajisja	Specifikimi
Pompat Nxehtësie Ajër-Ujë	Inverter, COP > 4.5 (ngrohje), EER > 3.5 (ftohje)
Njësitë Fan Coil	Sistemi me 2 tuba, me zhurmë të ulët, ventilatorë EC
Njësitë Trajtimi Ajri (AHU)	Me rrotë entalpie, normë rikuperimi energjie 70-80%
Tubacionet e Çelikut	Tuba çeliku ASTM A53 Grade B, schedule 40
Duktet e Çelikut të Galvanizuar	Trashësi fletë 0.8-1.2 mm, dukt spiral për rrjedhat kryesore
Sistemi i Kontrollit	I integruar me BMS, kontroll specifik për zonën dhe ventilimin

7.9 KONSIDERATAT E EFIKASITETIT

Sistemi HVAC për hotelin është projektuar me fokus në maksimizimin e efikasitetit energjetik. Karakteristikat kryesore që kontribuojnë në performancën e lartë përfshijnë:

- **Pompat Nxehtësie Ajër-Ujë:** COP dhe EER të larta sigurojnë ngrohje dhe ftohje efikase me konsum minimal të energjisë.
Të gjitha materialet, pajisjet, makineritë, instalimet dhe sistemet elektrike dhe elektronike do të bëhen dhe do të ndërtohen në menyren me te mire te mundshme. Për më tepër do të vendose tokëzimi i rregullt i të gjitha pjesëve metalike të pranishme si linjat e ujit, pjesët metalike të ashensorëve, pajisjeve motorrike etj. Linjat kryesore, që nisen nga paneli i shpërndarjes, do të mbrohen nga pajisjet kundër mbirrymave. Paneli i përgjithshëm elektrik përkatës do të vendoset në një pozicion lehtësisht të aksesueshëm, të sinjalizuar dhe të mbrojtur nga zjarri. Ndërtesa do të pajiset edhe me sistemet e mëposhtme:

Sistemi elektrik, në rast të një ndërprerjeje të energjisë nga rrjeti, do të integrohet automatikisht nga një sistem emergjence furnizimi me energji i mundësuar nga gjeneratore elektrike.

Autonomia e furnizimit me energji emergjente duhet të lejojë që evakuimi të kryhet në mënyrë të sigurt për kohën e nevojshme dhe në çdo rast do të plotësojë atë që është vendosur për çdo sistem me energji elektrike, përkatësisht:

Ndryçim sigurie

NA

- Sistem alarmi manual 30 minuta
- Sistemi automatik i detektimit 30 minuta

4.8.NDRICIMI I SIGURISE

Normalisht ndrimi i sigurise / emergjences konsiderohet i domosdoshem per godina mbi 32m lartes antizjarr, qe ne kete rast nuk perkon me lartesine antizjarr te godines.

5. PROFILI I RISKUT

Profili i rrezikut duhet te reflektoj karakteristiken e shfrytezimit (pika 6.2 dhe tabela 2) dhe norma e rritjes se zjarrit (pika 6.3 dhe tabela 3) per nje ndertese, dhe duhet te shprehet si nje vlere qe kombinon keto dy elemente (pika 6.4, tabela 4 dhe tabela 5).

5.1.Karakteristika e shfrytezimit

Tabela 2 Karakteristikat e shfrytezimit		
Karakteristikat e shfrytezimit	Pershkrimi	Shembuj
A	Përdoruesit të cilët janë zgjuar dhe të familjarizuar me ndërtesën	Objektet industriale dhe zyrat
B	Përdoruesit të cilët janë zgjuar dhe jo të familjarizuar me ndërtesën	Shops, exhibitions, museums, leisure centres, other assembly buildings etc.
C	Përdorues të cilët me shumë mundësi janë në gjumë	Apartamentet individuale pa mirëmbajtje 24 orë dhe pa menaxhim të kontrolluar në vend
Ci	Banesat individuale me afat të gjatë	Apartamente në bashkëpronësi ,zona rezidenciale , konvikte
Cii	Banesa me menaxhim afatgjat	Hotele
Ciii	Banesa me afat të shkurtër	Hotele
D (a)	Përdorues të cilët marrin mjekim	Spitale, qendra të kujdesit moshor (b)
E (c)	Përdorues me qëndrim të përkohshëm (transit)	Stacione treni, aeroporte
(a) Karakteristikat e shfrytezimit D , qendrat shëndetësore, trajtohen me një tjetër dokument dhe nuk bëjnë pjesë në këtë standart (b) Në disa rrethana qendrat e kujdesit moshor mund të klasifikohen nën karakteristikën e shfrytezimit Cii (c) Kjo karakteristikë e shrytezimit përfshihet për të qenë e plotë në këtë tabelë, por nuk shtjelohet në këtë Standart Shqiptar		

Tabela 2. Karakteristikat e shfrytezimit

Sipas karakteristikave te shfrytezimit, klasifikimi bie ne Grupin Cii.

5.2.Norma e rritjes se zjarrit

6.3 Norma e rritjes së zjarrit

Norma e rritjes së zjarrit është shkalla në të cilën është llogaritur se sa një zjarr mund rritet. Normat e rritjes së zjarrit duhet të kategorizohen në përputhje me Tabelën 3.

Kategoria	Norma e rritjes se zjarrit	Shembuj	Parametri I rritjes se zjarrit (a) kj/s3
1	E ngadalte	Materiale me djegshmeri te limituar	0.0029
2	Mesatare	kuti paketimi prej kartoni,paleta druri	0.012
3	E shpejte	Grumbull copezash plastike me termo-izolim, produkte plastike te prodhuara ne seri.Grumbull teshash	0.047
4	Shume e shpejte	Lengje te ndezshem, shkume dhe plastike me vete-zgjerim	0.188

Tabela 3. Norma e rritjes së zjarrit

Parametri mesatar i rritjes se zjarrit eshte [0.012kJ/s3](#), [Kategoria 2](#), [Norma Mesatare](#).

5.3.Formulimi i profilit te rrezikut

Profilat e rrezikut jane dhene si nje kombinim i karakteristikave te shfrytezimit dhe te normes se rritjes se zjarrit, sic tregohet ne Tabelen 4.

Profilat e rrezikut		
Karakteristika e shfytëzimit (nga tabela 2)	Norma e rritjes së zjarrit	Profilat e rrezikut
	1 E ngadaltë	A1
A	2 Mesatare	A2
(përdoruesit të cilët janë zgjuar dhe të familjarizuar me ndërtesën)	3 E shpejtë	A3
B	4 Shumë e shpejtë	A4
(Përdoruesit të cilët janë zgjuar dhe jo të familjarizuar me ndërtesën)	1 E ngadaltë	B1
	2 Mesatare	B2
	3 E shpejtë	B3
	4 Shumë e shpejtë	B4
C		
(Përdorues të cilët me shumë mundësi janë në gjumë)	1 E ngadaltë	C1
	2 Mesatare	C2
	3 E shpejtë	C3
	4 Shumë e shpejtë	C4
(a) Këto kategori janë të papranueshme nën qëllimin e AL-SP Shtimi I një sistemi parandalues efektiv dhe të lokalizuar ose sprucues uji do të ngadalësojë normën e rritjes së zjarrit dhe për pasojë sjell ndryshime në kategori (shih 6.5)		
(b) Profili I rrezikut C mund të ndahet në disa nënkategori , Ci1, Ci1, Cii1 etj.		
(c) Profili e rrezikut C3 nëse nuk i nënshtrohen masave të veçanta të kujdesit do të jenë të papranueshëm në shumë rrethana		

Tabela 4. Profilat e rrezikut

Shembuj tipikë të profileve të rrezikut	
Përdorimi	Profilet e rrezikut
Dhomë gjumi dhe studio	Cii2
Dhomë ndenje dhe me raste gjumi	Cii2
Dhome ngrënieje	B1
Kuzhinë	A3
Korridore, holle	B1
Recepsioni	B1
(a) Shiko tabelën 4. Profilet e rrezikut A4 janë të papranueshme nëse një sistem me spërkatje uji ose një sistem tjetër i përshtatshëm për të kontrolluar zjarrin nuk është i instaluar.	
(b) Duke përjashtuar hapësirat e mbuluara në qendrat tregtare komplekse dhe duke përjashtuar dyqanet e mëdha të shitjeve, por duke përfshirë ato të cilat përgjithësisht tregtojnë mobilje, shtrime dyshemeje, elektroshtëpiake dhe dyqane ushqimore	
(c) Përfshin supermarketet, dyqanet e veshjeve, dyqanet e pajisjeve personale, si tharëse flokësh	

Tabela 5 Shembuj tipikë të profileve të rrezikut

Sipas karakteristikave të shfrytëzimit dhe profilit të rrezikut, klasifikimi final konsiderohet si Grupi Cii2 dhe profilu i rrezikut C2 (tabela 2, 4 dhe 5).

6. DYERT E EMERGJENCES DHE RRUGET E SHPETIMIT

Ndertesat duhet të projektohen dhe pajisen në mënyrë të tillë që në rast emergjence banoret e ndertesës mund të shkojnë lehtësisht në një vend të sigurt.

6.1. Numri i rrugëve të shpëtimit

Një rrugë shpëtimit mund të bëhet e pakalueshme nga zjarri ose tymrat. Prandaj, në përgjithësi, duhet të ketë të paktën dy rrugë shpëtimi të ndryshme për çdo kat. Megjithatë në disa rrethana vetëm një drejtim shpëtimi mund të japë siguri të pranueshme. Numri i rrugëve të shpëtimit nga çdo dhomë, rrugë lidhëse ose kat duhet të jetë jo më pak se minimumi i rekomanduar në tabelën 11 për numrin e parashikuar të përdoruesve.

Tipologjia e ndërtesës (kate të cilësuar)	Përmbajtja e zonave të shpëtimit nga zjarri
Ndërtesa me lartësi nga 11 deri në 18 m.	Shkallë emergjence, kafaz i shpëtimit nga zjarri, i paventiluar, i pajisur me hidrantë zjarri.
Ndërtesa të percaktuara për t'u përdorur si dyqane ndërmarrjeje ose për përpunim dhe krijim, ku lartësia e katit të fundit i kalon 7.5 m, me një sipërfaqe të çdo kati mbi nivelin e tokës jo më të vogël se 900 m.	Shkallët e shpëtimit nga zjarri, kafazi i shpëtimit nga zjarri, i pajisur me hidrantë zjarri.
Ndërtesa ose pjesë të ndërtesës* ku lartësia e sipërfaqes së dyshemesë së sipërme i kalon 18 m duke përfshirë çdo kat që funksionon tërësisht si kat teknik.	Shkallët e shpëtimit nga zjarri, kafazi i shpëtimit nga zjarri, i pajisur me hidrantë zjarri. Instalim i ashensorit kundër zjarrit.
Ndërtesa ku thellësia e sipërfaqes së dyshemesë të katit të mëposhtëm i kalon 10 m.	Shkallët e shpëtimit nga zjarri, kafazi i shpëtimit nga zjarri, i pajisur me hidrantë zjarri. Instalim i ashensorit kundër zjarrit.
Ndërtesa që ka dy ose më shumë kate nën tokë, ku sipërfaqja e secilit kat i kalon 900 m.	Shkallët e shpëtimit nga zjarri, kafazi i shpëtimit nga zjarri, i pajisur me hidrantë zjarri.
*Termi i "pjesëve të ndërtesës" i referohet rasteve si blloqet në forme kulle, që ngrihen mbi një podium.	

Tabela 11. Masat e zonës së evakuimit nga zjarri

Ne rastin konkret kemi të bëjmë me godine që nuk i kalon 18m lartësi mbi tokë.

Referuar numrit maksimal të personave që do të përdorin shkallën në nivelin e katit është rreth 60 persona duke konsideruar një pjesë të ambjentëve janë salla mbledhjeje apo relaksimi që normalisht do të shfrytëzohen nga një personel.

Numri minimal i rrugëve dhe daljeve të shpëtimit nga një dhomë, rrugë lidhëse ose kat	
Numri maksimal i personave	Numri minimal i rrugëve dhe daljeve të shpëtimit
60	1
600	2
Më shumë se 600	3

Tabela 6 – Numri minimal i rrugëve dhe daljeve të shpëtimit nga një dhomë, rrugë lidhëse ose kat

Konsideruar kriteret e tabelës 6 dhe 11, shkallet e shpëtimit ndaj zjarrit janë të pajisura me dymantizarr dhe tym izoluese dhe me hidrante të pozicionuar në pjesën e korridorit të përbashkët.

6.2. Distanca e largimit

Distanca e lejuara të largimit sipas kriterëve në tabelën 7 jepen të evidentuara

Profili i rrezikut	Distanca e largimit në metra (m)	
	Largim në dy drejtime	Largim në një drejtim
A1	65	26
A2	55	22
A3	45	18
A4(b)	Nuk aplikohet (b)	Nuk aplikohet (b)
B1	60	24
B2	50	20
B3	40	16
B4(b)	Nuk aplikohet (b)	Nuk aplikohet (b)
C1	27	13
C2	18	9
C3(b)	14	7
C4(b)	Nuk aplikohet (b)	Nuk aplikohet (b)

Në rast se distancat e sakta të largimit nuk dihen, distancat direkte duhet të merren sa 2/3 e distancave të largimit

(a) Kjo është distanca maksimale e largimit të lejuar, kur niveli minimal i masave të mbrojtjes ndaj zjarrit janë të garantuara (shih pikën 10). Për shembull, gjatësia maksimale e largimit në një drejtim është 22 metra për një kategori A2 të rrezikut, sipas tabelës 10. Duke shtuar sistemin e spërkatjes së ujit, kategoria ndryshon në A1, kështu që maksimumi i largimit në një drejtim rritet në 26 m. Nëse sisteme të tjera shtesë të mbrojtjes ndaj zjarrit shtohen, mund të sigurohet edhe rritja e distancës së largimit.

(b) Shiko tabelën 4

Tabela 7 - Distanca maksimale e largimit kur merren masat minimale të mbrojtjes nga zjarri

Në rastin e hotelit, distanca maksimale e lejuar në tabelën 7 tejkalohet për faktorë shtesë të parës që kanë ndikim pozitiv në sigurinë e evakuimit janë:

- dritaret ventiluese parashikuar 2 për çdo kat në koridore
- sistemi i detektimit të tymit
- sistemi sinjalizimit

Si masa shtesë mund të konsiderohet edhe montimi i aspiratoreve të tymit në nivelin e katin me shufrë katin parkim.

6.3. Gjerësia e dyerve kur janë marre masat minimale të mbrojtjes

Distanca e dyerve sipas profilit të riskut dhe drejtimin ngjites apo zbrites jepen sipas tabelave më poshte:

Gjerësite e dyerve kur janë marrë masat minimale të mbrojtjes nga zjarri	
Profili i rrezikut	minimumi i gjerësisë së derës për person mm
A1	3.3
A2	3.6
A3	4.6
A4 (a)	Nuk aplikohet (a)
B1	3.6
B2	4.1
B3	6
B4 (a)	Nuk aplikohet (a)
C1	3.6
C2	4.1
C3 (a)	6
C4 (a)	Nuk aplikohet (a)
(a) Shih tabelen 4	

Tabela 8 – Gjerësitë e dyerve kur janë marrë masat minimale të mbrojtjes nga zjarri

Gjerësia minimale absolute e shkallëve		
Dimensionet e shprehura në milimetra		
Karakteristikat e shfrytëzimit	Gjerësia e shkallëve në zbritje	Gjerësia e shkallëve në ngritje
A	1000	1200
B (përveç të montuarave)	1100	1200
B (përveç të montuarave)	1000	1200
C		1200

Tabela 9 Gjerësia minimale absolute e shkallëve.

7. SISTEMET E PARANDALIMIT DHE MBROJTJES NDAJ ZJARRIT

7.1. Qëllimi i projektimit të parandalimit të zjarrit

Qëllimi i projektit të hartuar për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe për shpëtimin synon të demonstrojë arritjet e objektivave të mëposhtëm:

- sigurinë e jetës njerëzore
- mbrojtjen e pronës dhe të mjedisit
- ndihmoje personelin zjarrfikës

Për këtë qëllim, objektivat e parandalimit të zjarrit konsiderohen të arritura nëse aktivitete projektohen, zbatohen dhe menaxhohen në atë mënyrë që të:

- e) minimizojnë shkaqet e zjarrit ose shpërthimit;
- b) garantojnë qëndrueshmërinë e strukturave mbajtëse për një periudhë të caktuar kohe;
- c) të kufizojë prodhimin dhe përhapjen e zjarrit brenda aktiviteteve;
- d) të kufizojë përhapjen e një zjarri në aktivitetet ngjitur;
- e) të kufizojë efektet e një shpërthimi;
- f) garantojnë mundësinë që ekipet e shpëtimit të veprojnë në kushte të sigurta;
- g) mbrojnë ndërtesat me vlerë për artin dhe historinë e tyre;
- h) të garantojë vazhdimësinë e funksionimit për punët strategjike;
- i) të parandalojë dhe të kufizojë dëmtimin në mjedis në rast zjarri.

7.2. Rrjeti zjarrfikës i territorit

Ne pjesën e pasme të godines së parkimit është parshikuar një hidrant i jashtëm tip kolone me 2 dalje DN70 me prurje totale 460 lit/min. Kapaciteti i pompave është llogaritur për humbjen maksimale (pra pikën me të disfavorshme) por pozicioni i hidrantes së jashtme pranë stacionit të pompimit krijor kushte për humbje presioni minimale kështu që edhe prurja e kërkuar plotësohet.

7.3. Sistemet e brendshme të mbrojtjes

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri i objekteve përveç kërkesave të detyrueshme ligjore që kanë të bëjnë me normat/standartet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri, është realizuar duke konsideruar edhe arsyetimin teknik të projektuesit për masat shtesë që eventualisht duhet të merren në bazë të analizimit të faktoreve të godines.

Duke konsideruar gjeometrinë e godines, sipërfaqen e ambienteve (si për hotelin edhe për parkimin), aktivitetin me karakter publik, aksesin dhe distancat e rrugëve të shpëtimit dhe që kati -1 i parkimit është i tipit i mbyllur:

- per te gjithë katet parkim perفشire edhe ato me ventilim natyral, pervec hidranteve është parashikuar edhe sistem mbrojtje i tipit automatik me sprinkler.
- per te gjithë katet e hotelit është parashikuar mbrojtje hidrike me hidrante mural DN45 me prurje 120 lit/min.

7.3.1. Kriteret e pergjithshme projektuese

Impianti i mbrojtjes nga zjarri është parashikuar te ndertohet ne perputhje me kerkesat dhe norma specifike per aplikimin e sistemeve dhe pajisjeve te shuarjes, mbi baze te specifikave te zjarreve te mundshme, shkalles se rrezikshmerise si dhe destinacionit qe paraqesin ndarjet e ambienteve te ndryshme te godines ne teresi.

Bazuar ne destinacionet e ambienteve (parkim nentokesor, hoteleri) duke analizuar faktin qe ne godine per sistemet e perbashketa nuk do te perdoren lende djegese si gaz GPL dhe nafte, si dhe nga nje analize e zjarreve te mundshme rezulton se sistemi i shuarjes me uje nepermjet hidranteve dhe sprinklerave do te jete sistemi kryesor i mbrojtjes kunder zjarrit, por gjithashtu e shoqeruar me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lende shuarese tip puder dhe CO2 per ambjentet me instalime, mbi baze te klasave te zjarrit te cilat nuk mund te shuhen me uje.

Te dhenat projektuese per hidrantet UNI 45 jane: prurje 120 l/min dhe presioni ne dalje 2 ÷ 2.5 bar per mbrojtjen e nje siperfaqe deri 1 000 m² per klasat e zjarrit A-C, përjashtuar klasen E.

Te dhenat projektuese per sprinklerat e perzgjedhur jane: prurje 5 l/min-m² dhe presioni ne dalje nga 1÷2, per siperfaqe deri 144m² konsideruar destinacionin e perdorimit per qellime parkimi ne katin nentoke, ne vartesi te klases se zjarrit dhe shkalles se rrezikshmërisë OH2 (ref. EN12845, tab. A2).

Per sistemin e shuarjes me uje me hidrante dhe me sprinklera, efikasiteti i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit do te varet ne nje shkalle te larte nga mjaftueshmeria e kapacitetit te ujit dhe presionit te tij, te cilet duhet te jene te mjaftueshem per te mbrojtur siperfaqet specifike mbi baze te sasise se nevojshme te ujit, kohes se veprimit, numrit te hidranteve dhe spriklerave njekohesisht ne pune, siperfaqia e mbulimit te tyre dhe tipit te zgjedhur etj. Ndersa per sistemin e shuarjes portative efikasiteti i tyre konsiston ne vatra zjarri te lokalizuara, te te gjitha klasave A-C dhe E.

Faktoret percaktues te marre ne konsiderate gjate projektimit jane:

- Klasifikimi i zjarrit ne klasa;
- Natyra dhe permasa e zjarrit;
- Madhesia e zones qe do te mbrohet;

- Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;
- Kerkesat dhe normat europiane si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

Ne menyre te permbledhur, ne tabelen me poshte jepen llojet e mbrojtjes dhe parametrat perkates te parashikuar sipas kategorise se ambjenteve.

Ambientet	Klasa zjarrit	Shkalla rrezikshemrise	Mbrojtja	Parametrat
Territori			Hidrante DN100	Prurja:460 l/min Presioni ne dalje: 3.5÷4Ba
Parkim	B	OH2	Hidrante UNI 45 Sprinklera Fikesa portative	Prurja:120 l/min, 60min Presioni ne dalje: 2÷2.5Ba Njekohshmeria: 3 Prurja 5 l/min, 60min Presioni : 0.5 ÷ 1 bar Sip.min mbrojtur: 144 m ² Fikese me puder 55A-233 Fikese me CO2
Ambjete Hotelerie	A	OH1	Hidrante UNI 45 Fikesa portative	Prurja:120 l/min, 60min Presioni ne dalje: 2÷2.5Ba Fikese me puder 55A-233

7.3.2 Identifikimi i sistemeve te shuarjes se zjarrit

Sic e theksuam me siper ky sistem perfshin sistemet fikse manuale dhe automatike te shuarjes me Uje, gjithashtu dhe pajisjet shuarese portative me Puder apo CO2.

Sistemi i shuarjes me uje eshte i perbere nga:

- Çentrali teknik (rezerva ujore dhe grupet e presurizimit),
- Rrjeti i shperndarjes (kollonat furnizuese per hidrantet dhe sprinklerat),
- Sistemet shuarese fikse manuale (hidrantet),
- Sistemet shuarese fikse automatike (sprinklera),

Ndersa sistemi i shuarjes me pajisje portative:

- Pajisjet shuarese portative (puder, CO2).

7.3.2. Centrali i teknik

Centrali teknik i impiantit të mbrojtjes kundër zjarrit është parashikuar të instalohet në ambiente teknike në katin -1 nëntokë, të aksesueshëm direkt nga zona e parkimit. Ai përfshin rezervën e ujit dhe grupet e presurizimit për sistemin sprinkler dhe atë të fikjes me hidrante.

7.3.3. Llogaritjet kryesore të sistemit

Llogaritjet për dimensionimin e rrjetit të tubacioneve është bërë me anë të softwarit profesional duke konsideruar:

a) Flukset që korrespondojnë me receptorët e shuarjes së zjarrit konsiderohen si 60 l/min për spërkatësit dhe 120 l/min për hidrantet.

b) Flukset që grumbullohen në nyje (degë) të rrjetit.

c) Receptorët janë organizuar në grupe sipas gjeometrisë së ndërtesës.

d) Për shkak të funksionimit jo të njëkohshëm të të gjithë receptorëve, llogaritja merr parasysh pikur e fluksit të receptoreve që llogaritet në secilën degë të grupit më të disfavorshëm të receptorëve që është i lidhur me këtë degë, përkatësisht grupi që ka totalin e furnizimeve më të madh se grupet e tjera.

7.3.4. Llogaritjet e kapaciteteve minimale të depozitës së ujit

Për llogaritjen e vëllimit të depozitës janë konsideruar sa mëposhtë:

Ref. Vendim Nr.699, datë 22.10.2004 dhe UMPB nr. 424, datë 24.7.2015

Impianti duhet të ketë dimensione të atilla që të garantojë një prurje minimale prej 360 l/min për çdo kolonë të montuar dhe në rastin e shumë kolonave të garantojë funksionimin e njëkohshëm të tyre

Si rrjedhim konsideruar kompartimentin me të disfavorshëm llogaritim:

Parking

- për sistemin sprinkler: njëkohshmeria e konsideruar është

18 sprinkler x 5 lit/min-m² x 60 min = 64.800 lit

- për sistemin e hidranteve: 3 hidrante x 120 lit/min x 60 min = 21.600 lit

Total = 86.400 lit

Per dimensionin e volumit fizik te depozitave eshte konsideruar edhe volumi i pa shfrytezueshem qe vjen si rezultat i kuotes se thithjes dhe lartesis se mbushjes se depozites plus kapacitet shtese rezerve.

Konkretisht:

Depozita e ujit per sistemin sprinkler dhe hidrante eshte llogaritur qe te kete volum uji te shfrytezueshem prej **140.000 lit** konsideruar edhe faktin e aktivizimit te njekohshem te zones me te favorshme te sprinklerave qe korrespondon ne nje prurje te shtuar krahasuar me ate te zones me te disfavorshme.

7.3.5. Fikesat portabel dhe perzgjedhja e tyre ne baze te klasifikimit te zjarrit

Per te perdorur agjente shuares te pershtatshem gjate procesit te mbrojtjes nga zjarri, ne funksion te materialeve qe mund te marrin flake, jane marre ne konsiderate klasat e zjarrit. Ne baze te standarteve bashkekohore, pajisjet shuares te zjarrit jane klasifikuar ne pese klasa. Standart europian per keta shuarsa dallon klasat e meposhtme:

Klasa A - vlereson zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te ngurte sikurse derrase, leter, plastik tekstile, etj.

Klasa B - vlereson zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te lengshem sikurse benzene, benzole nafte, alkool, vajra etj.

Klasa C - vlereson zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te gazta sikurse metan, propan, butar GPL etj.

Klasa D - vlereson zjarre qe e kane origjinen prej materialeve metalike si alumin, magnez, natrium etj.

Klasa E - vlereson zjarre nga pajisje elektrike qe jane nen tension .

Sipas klasifikimit ne piken 3.0 te ketij relacioni, referuar tabelës me poshte eshte bere edhe perzgjedhja e fikesave portabel sipas destinacioneve te perdorimit:

Tabella - incendi di classe A e B			
tipo di estintore	Superficie protetta da un estintore		
	Rischio Basso	Rischio Medio	Rischio Elevato
13 A - 89 B	100 m²	-	-
21 A - 113 B	150 m²	100 m²	-
34 A - 144 B	200 m²	150 m²	100 m²
55 A - 233 B	250 m²	200 m²	200 m²

Kompartimentet e hotelerise

Klasifikimi

Sipas normës EN>	OH1- Ordinary Hazard
Sipas normës UNI 10779>	Niveli 2- i ulet
Kapaciteti i shuarjes>	jo me i vogël se 13A-89B per cdo 100m2
Pesha / volumi i fikses>	6 kg / 6lit Pluhur i presurizuar

Kompartimentet e parkimit

Klasifikimi

Sipas normës EN>	OH2- Ordinary Hazard
Sipas normës UNI 10779>	Niveli 3- i larte
Kapaciteti i shuarjes>	55A-233B per cdo 200m2
Pesha / volumi i fikses>	6 kg / 6lit Pluhur i presurizuar

Dhomat me instalime elektrike

Perdorimi

Ne ambiente>	me temp. -20°C deri +60°C
Aparatura elektrike>	nen tension deri 1.000V, ne distance 1m
Kapaciteti i shuarjes>	113B
Pesha e fikses>	5 kg CO2

Shenim:

Ngarkesa e aparateve fikese të zjarrit nuk mund të kalojë 6 kg ose 6 litra.
Fikëset e zjarrit me ngarkesa më të larta mund të përdoren vetëm në mjedise të destinuara për aktivitete industriale që nuk janë të aksesueshme për publikun, përveç rastit kur ato janë të shoqëruar nga personel i trajnuar.

8. PERSHKRIMI I PAJISJEVE DHE MATERIALEVE KRYESORE

8.1. Rezerva Hidrike

Ne katin -1 eshte parashikuar rezerva (depozita) e nevojshme e ujit. Kapaciteti i ujit ne depozite llogaritur ekskluzivisht per Mbrojtjen ndaj Zjarrit me Sprinkler dhe Hidrante eshte 140 m³. Ne ketë kat eshte parashikuar gjithashtu edhe lokali teknik per vendosjen e Pompave MNZ.

Rezerva e ujit do te jete ne formen e rezervuarit prej beton arme, mbi pllaken e themelit.

Materiali i rezervuarit do te jete kompozim i betonit me shufra hekuri, i armuar sipas specifikimeve teknike te inxhinerit konstruktor. Forma dhe dimensionet e tij jane parashikuar sipas vizatimin teknik

Rezervuaret e ujit do te kompletohen me instalimet si me poshte:

- Tubacioni i furnizimit me uje nga rrjeti, perfshire galexhant mekanik, filtra, valvola etj.
- Tubacion i thithjes se pompes bashke me filtrin ne hyrje
- Tubacion i linjes se testimit te pompes, kompletuar me valvol flutur
- Tubacion drenazhi per tejplotesin
- Pike drenazhi e kompletuar me saracineske per qellime pastrimi ose dhe drenazh te mbushje

8.2. Pompa MNZ

Ne perputhje me kerkesat e projektit, me sistemin e shuarjes se zjarrit (hidrante apo sprinklera) dhe me destinacionet e ambienteve te brendshme qe kane te njejta karakteristika projektuese jane parashikuar edhe grupet respective te presurizimit.

Grupet e presurizimit jane parashikuar te jene te vecanta, nje per sistemin sprinkler dhe nje per sistemin e mbrojtjes me hidrante.

Grupi i presurizimit per sistemin sprinkler eshte parashikuar te kompozohet nga nje elektropompe kryesore elektrike, te ushqyer si nga rrjeti normal elektrik dhe nje pompe kryesore diesel e pavaru dhe me kapacitet 100% te punes. Grupi i pompimi do te jete sipas normës EN 12845 dhe sygjerojne montimin dhe lidhjen e tyre me depon e ujit gjithashtu sipas normës EN 12845.

Grupi MNZ, pajisur dhe nga pompa jockey (prove) te inkorporuar me pompën master, janë seicila me lidhje me vehte me depon e ujit, dmth, me 3 lidhje - cdo pompe me vehte. Grupi MNZ eshte parashikuar qe te jete me te gjithë aksesoret e nevojshem te para instaluar ne fabrike, panel elektril kontrolli i cili do te komandoje secilen pompe

dhe pajisjet e tyre ne menyre te percaktur, nisjen, duke realizuar njekohesish monitorimin dhe sinjalizimet e nevojshem duke percaktuar keshtu statusin dhe kushte e stacionit te pompimit. Gjithashtu grupi eshte parashikuar te jete i kompletuar me aksesoret impiantistike perkates, si valvola nderprerese e komandimit, kolektorët e dergimit etj, sipas normës UNI EN 12845.

Po ashtu janë parashikuar kompletimi me sistemin e provave (testeve) të funksionalitetit te cilat përfshijnë:

- Linjën e daljes nga kolektori i dërgimit, pajisur me valvol nderprerese kryesore
- Flusometrin

- Linja e lidhjes per shkarkimin ne depo, paisur me valvol kontrolli

Per grupin e sprinklerave eshte parashikuar valvol kontrolli sprinklerash e tipit "e njome" (sipas skemës), qe perfshin:

- Nje valvol nderprerese kryesore ,
- Nje valvol kontrolli dhe alarmi,
- Nje zile hidraulike alarmi, (montuar ne katin 0)
- Nje valvol shkarkimi,
- Pajisjet e proves,
- Dy manometra,

Grupi i presurizimit per sistemin e hidranteve eshte parashikuar te kompozohet nga nje elektropompe kryesore elektrike dhe nje pompe elektrike rezerve, te ushqyer si nga rrjeti normal elektrik ashtu edhe nga rrjeti i emergjences. Grupi i pompimi do te jete sipas normës DIN 14462 dhe sygjerojne montimin dhe lidhjen e tyre me depon e uji gjithashtu sipas normës EN 12845.

Pompat MNZ per montimin dhe lidhjen me depon e ujit duhet te respektojë kërkesa teknike te prodhuesit (sipas tipit dhe markave te prodhimit te pompave), ne baze te prezantimit ne vend, gjithashtu hapja e vrimave te behet sipas detajeve te dhena ne projekt per cdo pome duke respektuar ne tërësi kërkesat e montimit te tyre sipas kerkesave te prodhuesit dhe normes EN 12845.

8.3. Parametrat teknik te grupit MNZ

Parametrat teknik te **grupit MNZ** te presurizimit per sistemin sprinkler, te llogaritur mbi baze te prurjes se kerkuar te barabarte me min.1080 l/m, presionit ne dalje te sprinklerave ne pozicionir hidraulik me te disfavorshem te rrjetit te barabarte me 1-2 bar, hidrant ne pozicionin hidraulik me te disfavorshem te rrjetit te barabarte me 2-2.5 bar dhe humbjeve te rrjetit mbi baze te formules Hazer Williams. Karakteristikat e llogaritura te punes jane:

Prurja: 1080 lit/m

Humbja: 55 mkH₂O

Parametrat teknik te **grupit MNZ** te presurizimit per sistemin hidrante, te llogaritur mbi baze te prurjes se kerkuar te barabarte me min. 360 l/m, presionit ne dalje te hidrantit ne pozicionin hidraulik me te disfavorshem te rrjetit te barabarte me 2-2.5 bar dhe humbjeve te rrjetit mbi baze te formules Hazen Williams. Karakteristikat e llogaritura te punes jane:

Prurja: 360 lit/m

Humbja: 56 mkH₂O

8.4. Rrjeti i shperndarjes

Rrjeti i shperndarjes eshte parashikuar te ndertohet me tuba dhe rekorderi celiku te tipit pa tege saldimi (Manesman), te serise se mesme te cilat do te respektojne normat dhe kushtet teknike per impiantin e mbrojtjen kunder zjarrit. Rrjeti i shperndarjes sipas ndarjes se sistemit, do te furnizohet nga nje linje kryesore nga grupi i presurizimit respektiv ne ambientin teknik duke e shperndare ne kollonat furnizuese respektive.

Gjate projektit eshte marre parasysh qe rrjeti i tubacioneve te kete minimumin e numrit te perkuljeve dhe te kthesave te detyrueshme. Tubat jane te pozicionuar dhe te siguruar per te minimizuar demtimet dhe vibrimet.

Linjat e rrjetit te shperndarjes, si per rrjetin e hidranteve edhe per rrjetin e sprinklerave, jane parashikuar kryesisht me bashkim Victaulic, ose me fileto kur kerkohet nga bashkimi i elementeve (valvola etj), ose kur diametrat e bashkimit jane nen DN50 (2"). Tubacionet do te jene te trajtuar ne siperfaqe, te pastruara nga ndryshku dhe vajrat, te zinkuara ose te lyera me boje antindryshk dhe boje te kuqe RAL 3000 dhe te pjekur ne fabrike sipas normave. Fiksimi i tyre do te behet me fasheta specifike dhe suporte mbeshtetese ne fund te kolonave. Ne cdo degezim do te vendosen valvola nderprerese si dhe ne rrjetin e sprinklerave do te parashikohen valvola shkarkimit te proves etj, sipas kerkesave te projektit ne perputhje me normen UNI EN 12485.

8.5. Kërkesa instalatore per impiantet shuarese fikse

Impiantet te palevizeshme (fikse) te shuarjes se zjarrit jane :

- Hidrantet
- Sprinklerat
- Lidhjet me autopompen
- Hidrantet e zjarrit do te perzgjidhen te tipit kasete ne brendesi te godines.

Ata do te parashikohen te instalohen ne çdo kat ne afersi te kafazit te shkalleve dhe te ashensori ku ato jane lehtesisht te evidentueshme, praktike per tu perdorur ne rastet e shfaqjes se zjarrit dhe ne mbulimin e sipërfaqes qe mbrojne. Hidrantet jane te perbere prej saraçineskes nderprerese, tubi te fleksibel te gomuar per kalimin e ujit me nje gjatesi standart prej 20m, si dhe me hundëza te hedhjes se ujit me larghedhje jo me pak se 5m. Te gjitha keto pajisje jane te vendosura ne boksir prej llamarine çeliku, te lyer me boje te kuqe RAL 3000 te pjekur, i cili vendoset ne brendesi te muri (sipas zgjidhjes ne projekt) dhe ne nje lartesi 110 cm nga dyshemeja sipas normave.

- Sprinklerat si pajisje fikse automatike sprucojne ujin ne rast zjarri. Ata jane ndertuar me bult me merkur te taruar ne temperature nominale 68°C, me lidhje me filetimit DN 20, te instaluar me koken drejtuar lart (upright) ose poshte (pendent). Sipas ketyre specifikave do te perzgjidhet lloji sprinklerit, prurja dhe presioni ne dalje te tij ne rast zjarri.
- Impiantet e mbrojtjes kundra zjarrit jane parashikuar te sigurojne 1 lidhje per cdo shkalle me autopompen e zjarrfikseses. Kjo lidhje eshte parashikuar ne pjesen hyrese te godines ne katin 0 ku eshte dhe kolona e hidrantes.

8.6. Sinjalistika

Nje element shume i rendesishem eshte shoqerimi i te gjitha pajisjeve shuarese, rrugeve te kalimi e te shpetimit, ose ambienteve te vecanta me sinjalistikat perkatese me kartela sipas normave pa dhe me ndricim normal apo me ndricim emergjence. Ne projektin e mbrojtjes kundra zjarrit jane parashikuar nje numer tabelash paralajmeruese, treguese dhe vepruese si me poshte:

- Tabela paralajmeruese – jane tabelat qe tregojne ndalimin e ndezjes se zjarreve ndalimit te perdorimit te ujit per shuarje etj.
- Tabela treguese – sic jane drejtimet e daljes neper korridore, neper shkalle, vendosja e hidranteve dhe te bombolave etj.

- Tabelat vepruese – sinjalizimi nepermjet butonit te alarmit, nderprerja e energjise elektrike etj.

Te gjitha sinjalet, kartelat dhe tabelat sinjalizuese do te jene te tipit te thjeshta "Vizuale", te ndricuar nga ndricimi i ambient dhe nga bateria e emergjences.

8.7. Hapat per Evakuim dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit

Siguria nga zjarri ne objektet rezidenciale

Perdoruesit e objektit duhet te njihen me standardet e sigurise si dhe me hapat qe duhet te ndjekin ne rast emergjence ndaj zjarrit.

Siguria nga zjarri ndahet gjeresisht ne tri aspekte:

Evakuimi

- Evakuimi i nje numri te caktuar njerezish nga objekti duhet te realizohet shpejt dhe me lehtesi.
- Vend grumbullimi eshte pozicioni i percaktuar i cili sherben si destinacion paraprak gjate daljes nga ndertesa dhe konsiderohet nje zone e sigurt evakuimi dhe qe nuk pengon nderhyrjen e autoriteteve per fikjen e zjarrit dhe/ose procesin e shpetimit.

Parandalimin e zjarrit

Çdo aspekt i projektimit dhe ndertimit duhet te zbatohet me parandalimin e zjarrit ne mendje.

Përballja me një zjarr

Sigurohuni qe ju te keni aparatet dhe njohurite e duhura per te fikur zjarrin me pajisjet e percaktuara per kete qellim.

SEKSIONI 3 SISTEMI I VENTILIMIT TE PARKIMEVE

3.1. Baza normative

EN 7346-7 Components for smoke and heat control systems

D.M. 1/2/1986 Norme di sicurezza antincendi per la costruzione e l'esercizio di autorimesse e simili

3.2. Peshkrimi i sistemit te projektuar

Sipas siperfaqes dhe volumetrisë së kateve të godinës të destinuar për Parking, bazuar në normat teknike dhe rregulloret teknike, duhet të parashikohet një Impiant Ventilimi Mekanik që duhet të plotësojë dy funksione kryesore.

Ventilimi i zakonshëm, i projektuar për të hequr (ose për të përmbajtur nivelin) ndotjen e prodhuar nga automjetet, duke siguruar përputhjen me parametrat e pranueshme në lidhje me karakteristikat e cilësisë së ajrit.

Ventilimi për qëllimin e evakuimit të produkteve të djegies për siguri kundër shpërthimeve dhe në rast zjarri: projektuar për të mbajtur nën kontroll tymin dhe gazrat e nxehtë të lëshuar gjatë një zjarri, duke garantuar kështu evakuimin e produkteve të djegies, evakuimin e banorëve si dhe duke lehtësuar ndërhyrjen e ekipeve të zjarrfikësve.

3.2.1. Ventilimi i zakonshëm

Perzgjedhja e kapaciteteve ventiluese varet nga rregullorja e secilit vend, qëllimit për të cilin do përdoret (tipi godinës-rezidenciale), kushteve atmosferike (mesdhetare) dhe standartit të kualitetit të mjeteve që janë në qarkullim.

Në tabelën me poshtë jepen efektet që vijnë si pasojë e përqendrimit në niveleve të ndryshme të CO dhe NO₂.

Tabela e mëposhtme përmbledh disa efekte shëndetësore për shkak të ekspozimit të zgjatur ndaj përqendrimeve të ndryshme të CO në ajër.

Niveli i CO	Gjendja & Efektet Shëndetësore	Instituti
0 ppm	Ajri normal, i pastër	
9 ppm	Ekspozimi maksimal i lejueshëm afatshkurtër	ASHRAE
10-24 ppm	Efektet e mundshme shëndetësore me ekspozim afatgjatë	
25 ppm	Ekspozimi maksimal TWA për 8 orë në ditë pune	ACGIH
50 ppm	Ekspozimi maksimal i lejuar në vendin e punës	OSHA
100 ppm	Dhimbje koke e lehtë pas 1-2 orësh	
200 ppm	Marramendje, vjellje, lodhje, dhimbje koke pas 2-3 orësh ekspozimi	
400 ppm	Dhimbje koke dhe vjellje pas 1-2 orësh ekspozim / Kërcënuese për jetën në 3 orë	
800 ppm	Dhimbje koke, nauze dhe marramendje pas 45 minutash / Kolaps dhe humbje ndjenjash pas 1 ore ekspozim / Vdekje brenda 2-3 orëve	
1600 ppm	Dhimbje koke, të përziera dhe marramendje pas 20 minutash ekspozim / Vdekja brenda 1-2 orësh	
3200 ppm	Dhimbje koke, nauze dhe marramendje pas 5-10 minutash / Kolaps dhe humbje ndjenjash pas 30 minutash ekspozim / Vdekje brenda 1 ore	
6,400 ppm	Vdekja brenda 30 minutave	
12800 ppm	Efekte fiziologjike të menjëhershme, humbja e vetëdijes / Vdekja brenda 1-3 minutave nga ekspozimi	

Per ventilimin e zakonshëm ditor, i jemi referuar rregullores Italiane duke konsideruar qe si per ceshtje kushtet klimaterike ashtu edhe nje pjese e rregulloreve tona vendore i janë referuar atyre Italiane.

1. Ventilazione per monossido di carbonio CO

	CO Ventilazione
Spagna	120 l/s posto · car = 432 m ³ /h posto auto (~ 6 ricambi aria per ora)
Regno Unito	6 ricambi aria per ora
Paesi Bassi	3 l/s · m ² = 90 l/s · car = 324 m ³ /h · posto auto
Francia	600 m ³ /h · posto auto
Portogallo	300 m ³ /h · posto auto
Italia	3 ricambi aria per ora

Normalisht te gjitha katet e parking-ut nentokesor aty ku eshte e mundur, duhet te pajisen me te cara per te garantuar sa me shume siperfaqe qe sigurojne ventilimin natyral. Per siperfaqe te lire ajrimi $\geq 4\%$ e siperfaqes totale e parkimit te shperndare ne menyre optimale dhe per distanca respektive jo me te medha se 40 m, nuk eshte e detyrueshme te aplikohet ventilimi mekanik per nevoja ventilimi te zakonshem.

3.2.2. Ventilim i emergjences

Vec ventilimit natyral, eshte e domosdoshme te parashikohet nje sistem ventilimi mekanik per largimin e tymrave ne rast zjarri i cili te aktivizohet manualisht ose/dhe automatikisht ne rastet kur sasia e CO dhe NO₂ ne ambient kalon vleren e parashikuar.

Sipas normes Europiane EN 7346-7, kapaciteti i ventilimit mekanik per largimin e tymrave duhet te jete 10 vol/h e kompartmentit me te madh.

BS 7346-7:2006

9.2 Calculation procedures

The exhaust ventilation system should be designed to provide a minimum of 10 air changes per hour for the largest car park storey or fire compartment served by that system and should be applied to the calculated volume of each car park storey or compartment.

Shkarkimi i tymrave duhet te behet ne pozicione te posacme te percaktuara ne projekt me qellim qe te sigurohet ana funksionale por njekohesisht te mos cenohet aktiviteti i ambjenteve te banimit.

3.3. Specifikime te sistemit

Ventilimi mekanik i parashikuar ne projekt perfshin ventilatorë aksiale te certifikuar per temperatura deri ne 400°C te pajisur me silenciatore me qellim reduktimin e zhurmave dhe ventilatorë me induksion (zhvendosje) me 2 shpejtesi te cilët montohen ne tavan dhe shërbejnë per pastrimin nga tymi te rrugeve te hyrjes se brigadave PNMZSH.

Per katet parkim, sistemi i ventilimit aktivizohet automatikisht nga impjanti i detektimit te zjarrit dhe/ose detektorët CO dhe NO₂ te parashikuara per instalim ne ambjentet e katit parkim.

Kompensimi i sasise se larguar te ajrit behet nëpërmjet rampës dhe çarjeve te parashikuara per ventilim natyral.

Ventilatorët aksiale do te jene pavribrime, elektrikisht te sigurta dhe te testuara ne fabrike ne perputhje me EN 12101-3 dhe te shoqeruara me certifikaten perkatese.

Kasa e ventilatorit do te jete prej llamarine celiku te galvanizuar dhe me izolim akustik perfshire dhe silenciatore.

Motoret do te jene IEC standart ne perputhje me EN 60034-5, me eficence te larte ne perputhje me Direktiven 327/2011.

Ventilatorët me induksion (zhvendosje) do te jene te tipit centrifugal, me dy shpejtesi, te përshatshëm per lartesi te reduktuara te ambjentit dhe per perdorim ne parkime te mbyllura, te certifikuara CE nga BSI dhe te testuara ne perputhje me EN 12101-3.

Fletet do te jene prej llamarine celiku te galvanizuar te balancuara ne perputhje me ISO 1940-1, G6.3, te projektuara me nje forme aerodinamike qe te mundesoje maksimumin e hedhjes dhe nivel sa me te ulet te zhurmes.

3.4. Aktivizimi i sistemit (ne rast instalimi te detektorëve)

Vlerat e aktivizimit te sistemit sipas përqendrimit te gazeve CO dhe NO₂ jepen ne tabelën me poshtë:

DEFAULT SETTING CONFIGURATION FOR THE VARIOUS STANDARDS AND RELAY OUTPUTS

Standard	Ventilation ON	Ventilation OFF	Entry delay	Output delay	Alarm level	Group Nr./ Gases	Relay outputs
Spanish 1 gr. Spanish 2 gr.	50ppm	<50ppm	1m	2m	100ppm instantaneous	1/1 gas 2/2 gases	Relays 1 and 2 1 relay per group
Spanish with NO ₂	3ppm	<3ppm	None	5m	10ppm instantaneous		

3.5. Kompartimentet dhe skenarët e funksionimit

Parkimi ne katin -1 funksionon si nje kompartiment i tere.

3.5.1. Ventilim i zakonshëm

Ne kushte normale, me aktivizim manual nga stafi menaxhues (ose me ane te sensoreve CO dhe NO₂) do te aktivizohen:

- ventilatoret “Jet fan” funksionojnë njëkohësisht ose individualisht sipas nevojës ne shpejtësi te ulet,

- ventilatoret aksiale te nxjerrjes se ajrit aktivizohen vetëm 1 nga cifti per cdo kat te secilës ndarje

3.5.2. Ventilimi i emergjences

Ne rast zjarri ose tejkalimi te nivelit te ndotjes:

- ventilatoret “Jet fan” te zonës se emergjences funksionojnë njëkohësisht ne shpejtesine e larte

- ventilatoret aksiale te nxjerrjes se ajrit te katit te ndarjes qe i takon zona e emergjencës aktivizohet te katert njëkohësisht

Error! Unknown document property name.

Error! Unknown document property name.

**NORMAL AND FIRE REGIME VENTILATION -
CAPACITY CONSIDERATIONS**

FLOOR	Floor -1
Total area	6742 m2
Total car number	238 cars

CO ventilation	Criteria	
Spain	432 m3/h-car	102,816 m3/h
UK	6 ACH	111,648 m3/h
France	324 m3/h-car	77,112 m3/h
Portugal	300 m3/h-car	71,400 m3/h
Italy	3 ACH	55,824 m3/h
Considered		
Normal Ventilation	3 ACH	55,824 m3/h
Total exhaust area	3 m2	5 m/s
Total recirculating area	6 m2	2.5 m/s

FIRE regime ventilation	Criteria	Resultet Air flow
Spain	540 m3/h-car	128,520 m3/h
UK	10 ACH	213,047 m3/h
France	600 m3/h-car	142,800 m3/h
Portugal	600 m3/h-car	142,800 m3/h
Italy	6 ACH	127,828 m3/h
Considered		
Fire regime	10 ACH	213,047 m3/h
Total exhaust area	6 m2	10.00 m/s
Total recirculating area	24 m2	2.50 m/s



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

**“NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT MULTIFUNKSIONAL ME
SHUMË NIVELE NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE
"NËNË TEREZA" TIRANË (QSUT)**

Relacioni Teknik



SHTATOR, 2024

KONSULENTI: **ICE** | ILLYRIAN
CONSULTING
ENGINEERS

Investitori:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Konsulenti:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Titulli i Projektit:	Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)
Titulli i Dokumentit:	Relacioni Teknik
Faza e Projektit:	Projekt Leje

Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për miratim		Shtator, 2024

	KONSULENTI			INVESTITORI	
	Përgatiti:	Kontrolloi / Miratoi:	Firma:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri Firma:	Bledi Saraçi	Olset Haxhiu			
Data:	Shtator, 2024	Shtator, 2024	Shtator, 2024		
Statusi i Dokumentit:	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2020

Copyright © Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers sh.p.k (ICE)"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	4
2 Synimi	5
2.1 Përshkrim i Përgjithshëm dhe Vendndodhja	5
2.2 Analiza arkitektonike	6
2.2.1 NDËRTESA E PARKIMIT	8
2.2.2 NDËRTESA E HOTELIT	8
2.2.3 Qëllimi i punës	9
2.2.4 Korsitë e manovrimit	10
2.2.5 Akseset	10
2.2.6 Dyshemeja	10
2.2.7 Ventilimi	11
2.2.8 Vendparkimet	11
2.2.9 Evakuimi i emergjencës	11
2.2.10 Ndërhyrjet e propozuara në projektin e Hotelit	12
3 Kriteret e projektimit	13
3.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike	13
3.2 Kriteret dhe normat për durueshmërinë ndaj zjarrit të strukturës:	13
3.3 Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale	1
3.3.1 Themelet	1
3.3.2 Konstruksioni b/a dhe muratura	1
3.3.3 Tarraca dhe hidroizolimi i saj	1
3.3.4 Suvatimet dhe lyerja e mureve	1
3.3.5 Fasada	1
3.3.6 Shtresat e pllakave	1
3.3.7 Dyert dhe dritaret	1
3.3.8 Ambientet sanitare	1
3.3.9 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve	1
3.3.10 Sistemi elektrik i ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë	2
3.3.11 Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)	3
3.3.12 Sistemi i lajmërimit për zjarrin	3
3.3.13 Bombolat fikëse të zjarrit	3
3.3.14 Shkallët e emergjencës	3
3.3.15 Ambienti teknik	3
3.3.16 Sistemi i Kondicionimit	3
3.3.17 Muret ndarëse të brendshme	3
3.3.18 Hapësira e katit -1, Parkimi Nëntokësor	3
3.3.19 Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara	3

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Të dhënat kryesore të objektit 7

LISTA E FIGURAVE

Figura 2-1: Foto Ajrore - Largësia nga Qendra e Tiranës.....	5
Figura 2-2: Foto Ajrore - Konturi i Kampusit QSUT.....	6
Figura 2-3: Planvendosja	7
Figura 2-4: Foto e Hyrjes kryesore dhe zonës së ndërhyrjes për studim, QSUT	9
Figura 2-5:Pamje nga Projekt Ideja Paraprake e parkimit	10

1 HYRJE

Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT) është njësi më e rëndësishme mjekësore në Shqipëri. Ajo funksionon si Qendër Spitalore, si një institucion mësimdhënës dhe si qendër kërkimore. QSUT-ja shërben si spitali primar mësimdhënës në vend për Universitetin e Shkollës Mjekësore të Tiranës dhe për Shkollën e Infermierisë. Ai është edhe institucioni lider për mjekësinë e nivelit të tretë në vend. Është qendra spitalore më e madhe në vend, me një kapacitet prej rreth 1400 shtretërish, ku kurohen më shumë se 50.000 pacientë në vit. Në bazë të statistikave dhe raportimeve më të fundit, numri i automjeteve ku përfshihen ato të personelit, pacientëve dhe/ apo familjarëve të tyre, bashkëpunëtorëve të ndryshëm, etj. që hyjnë, parkohen dhe dalin gjatë gjithë ditës në ambientet e QSUT është rreth 4.000 automjete në ditë apo 120.000 automjete në muaj. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është autoriteti kontraktues për këtë kontratë. FSHZH është një agjenci, misioni i së cilës është promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, nivel të balancuar dhe kohezion rajonal dhe lokal. Kuadri ligjor për krijimin dhe funksionimin e FSHZH-së përbëhet nga Ligji nr.10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit". FSHZH zbaton projekte të financuara nga Donatorët Ndërkombëtarë dhe Qeveria shqiptare me fushën e zhvillimit lokal dhe rajonal. Në kuadër të Programit Operacional 2022-2028 të FSHZH-së, miratuar me Vendimin Nr. 225 Datë 23.03.2022 të Këshillit Drejtues të FSHZH, është parashikuar të financohet Projekti "Ndërtimin e godinës së parkimit multifunksional me shume nivele ne Qendren Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)", pjesë e Kategorisë së ndërhyrjes 1.2.4 "Ndërhyrje për ndërtimin e Infrastrukturës së Transportit, Parkimeve, Stacioneve multimodela, moleve, etj. Kjo ndërhyrje parashikon të financojë kthimin e ambienteve publike në territorin e QSUT në hapësira ku ofrohet shërbim i standartit të lartë të mobilitetit nëpërmjet sigurimit të hapësirave të parkimit dhe faciliteteve të nevojshme, për funksionimin dhe qëndrueshmërinë e investimit.

2 SYNIMI

Projekti synon të:

- a- të lehtësojë lëvizjen e ambulancave dhe pacienteve, të personelit mjekësor, të studenteve, të vizitoreve, të mjeteve të shërbimit (furnizimi i spitaleve dhe grumbullimit të mbetjeve) si dhe shërbimit ambulator, nëpërmjet menaxhimit të parkimit publik
- b- krijojë lidhje më të mirë me aksin kryesor ekzistues në zonë, si dhe të lehtësojë aksesin me Menaxhimin e parkimit publik, nëpërmjet ndërtimit të një objekti për parkime, përcaktimin e vendparkimeve të mundshme në zona të ndryshme brenda territorit të QSUT-së në mënyrë që të stacionohen sa më shumë automjete që të jetë e mundur të cilët për arsye të ndryshme aksesojnë kompleksin spitalor, duke siguruar në këtë mënyrë një qarkullim dhe grumbullim funksional të tyre,“.
- c- Ndërtimin e një objekti hotelerie, i cili do të sigurojë akomodimin e familjarëve që shoqërojnë pacientët e qendrës spitalore, etj.

2.1 Përshkrim i Përgjithshëm dhe Vendndodhja

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” pozicionohet në skajin veri-lindor të kryeqytetit. Zona, objekti i këtij studimi, ndodhet në një largësi rreth 2 km në vijë ajrore, nga qendra e Tiranës.



Figura 2-1: Foto Ajrore - Largësia nga Qendra e Tiranës

Kompleksi i QSUT-së kufizohet me disa prej rrugëve kryesore të qytetit, siç janë Rruga e "Dibrës" në veri, Rruga "Bardhyl" në perëndim dhe Rruga "Kongresi i Manastirit" në jug, ana lindore shtrihet ngjitur me ambientet e Gjimnazit "Eqrem Çabej".



Figura 2-2: Foto Ajrore - Konturi i Kampusit QSUT

2.2 Analiza arkitektonike

Objekti zhvillohet ne territorin e QSUT, ne anën veriore nga rruga e Dibrës. Përbehet nga nje parkim ne shume nivele dhe një hotel ne anën veriore. Kufizohet me godinën e urgjencës ne anën lindore. Hyrja për ne godinën e parkimit dhe për hotelin me automjet zhvillohet në anën perëndimore.




Figura 2-3: Planvendosja

Tabela 2-1: Të dhënat kryesore të objektit

Përshkrimi	Parkimi	Hoteli
Sipërfaqja e katit nëntokë [m ²]:	7047	770
Sipërfaqja e gjurmës së objektit, kati përdhe [m ²]:	7047	770
Sipërfaqja e totale e ndërtimit [m ²]:		
Numri i dhomave		69
Numri i parkimeve	1406	
Lartësia maksimale e strukturës, përfshirë parapetin [m]:	1811	1811
Lartësia dysheme-dysheme e katit të përdhe [m]:	3.57	3.57
Lartësia dysheme-dysheme e katit tip [m]:	3.06	3.06
Numri i kateve mbi tokë:	5	5
Numri i kateve nën tokë:	1	1

2.2.1 NDËRTESA E PARKIMIT

Qendrës Spitalore propozohet t'i shtohet ndërtesa e parkimit si një volum 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë. Ajo lidhet me Ndërtesën e Re të Mjekësisë së përgjithshme dhe Ndërtesën Kryesore të Urgjencës nëpërmjet hapësirës në anën lindore. Ndërtesa e parkimit pozicionohet në hyrjen kryesore të QSUT-së, në perëndim të ndërtesës ekzistuese të urgjencës.

Hyrja në objekt bëhet nga rruga e hyrjes kryesore në pjesën jugore, aty ku aktualisht gjendet rreth-rrotullimi dhe dalja nga objekti është në pjesën veriore të tij, po në rrugën e hyrjes për në kompleks. Në këtë mënyrë sigurohet një qarkullim unazor në ndërtesën e parkimit me qëllim që të mos pengohet fluksi i lëvizjes por duke iu përmbytur sistemit të kontrollit, pasi akset e hyrje-daljes në objekt i bashkohen aksit të lëvizjes në pikën e traut të kontrollit pranë rrugës së "Dibrës". Kapaciteti i ndërtesës propozohet të ketë rreth 1 340 vendparkime.

Volumi është i hapur dhe do të konsistojë në strukturën mbajtëse të godinës dhe parapetet anësore për arsye sigurie. Ambientet do të jenë të pajisura me sinjalistikën e evakuimit në rast zjarri dhe elementët e nevojshëm për mbrojtjen nga zjarri. Në tarracën e objektit do të vendoset edhe pista e uljes së Helikopterit, dhe impjantet përkatëse në shërbim të ndërtesës së parkimit.

Komunikimi vertikal për këmbësorët realizohet nëpërmjet 4 nukleve të shkallë-ashensorëve të vendosur në skajet e objektit.

Fasada e ndërtesës së parkimit do të vishet me një strukturë metalike ku do të mbillen bimë kacavjerrëse që do të veshin të gjithë fasadën.

2.2.2 NDËRTESA E HOTELIT

Kjo ndërtesë propozohet të pozicionohet në veri të ndërtesës së parkimit, përgjatë rrugës së "Dibrës" dhe në krahun perëndimor të ndërtesës kryesore të Urgjencës. Volumi parashikohet të jetë 5 kate mbi tokë ku do të gjenden shërbimet e pritjes dhe të logjistikës dhe një kat nëntokë në të cilin do të pozicionohen ambientet teknike në funksion të Hotelit.

Akresi në Hotel do të jetë i kontrolluar dhe i koordinuar me pjesën tjetër të Kompleksit Spitalor në mënyrë që ti shërbejë sa më mirë të afërmeve që shoqërojnë pacientët e shtruar që vijnë nga rrethet.

Komunikimi midis ndërtesës së Hotelit dhe Spitalit të Mjekësisë së Përgjithshme do të bëhet nëpërmjet një nukli shkallë-ashensorësh pikën e lidhjes së tyre dhe hyrja do të kontrollohet nëpërmjet një sistemi akresi me karta. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë do të komunikojë edhe me ndërtesën e parkimit. Hoteli parashikon rreth 60 dhoma me kapacitet prej 120 shtretërisht. Në tarracën e ndërtesës do të pozicionohen impjantët e ajrim-kondicionimit. Sistemet inxhinierike do t'i përmbahen me rigorozitet standarteve të projektimit.



Figura 2-4: Foto e Hyrjes kryesore dhe zonës së ndërhyrjes për studim, QSUT

2.2.3 Qëllimi i punës

Qëllimi i punës është realizimi me standarde ndërkombëtare të godinës së parkimit së bashku me hotelin, të mjediseve të zyrave administrative dhe hapësirave për menaxhimin e trafikut brenda dhe jashtë godinës, si dhe realizimin e infrastrukturës lidhëse të godinës së parkimit me sistemin rrugor.



Figura 2-5:Pamje nga Projekt Ideja Paraprake e parkimit

2.2.4 Korsitë e manovrimit

- Gjerësia e rrugëve të kalimit duhet të jetë minimumi 4.5m-5m për rrugë pingul me vendet e parkimit.

2.2.5 Akseset

- Hyrjet dhe daljet janë të evidentuara me sinjalistikën përkatëse. Çdo kompartiment duhet të ketë të paktën:
 - a. një çift rampash me një sens kalimi me gjerësi 5 m për korsi,
 - b. rampat kanë pjerrësi maksimale 12% dhe me rreze të matur në pjesën e jashtme, jo më të vogël se 8.25m .

2.2.6 Dyshemeja

- Ka pjerrësi të mjaftueshme për largimin e ujërave sipërfaqësor.
- Shtrimi duhet është me material jo të thërmueshëm dhe jo të përshkueshëm.

2.2.7 Ventilimi

Ventilimi është natyral në katet mbi tokë dhe mekanik në katin nëntokë.

2.2.8 Vendparkimet

Janë parashikuar të jenë 2.5x5m për parkimet normale dhe 3.7x5m për personat me aftësi të kufizuar.

Janë:

- 30 vendparkime për personat me aftësi të kufizuar.
- 10 vendparkime për makina elektrike.
- 1366 vendparkime konvencionale

2.2.9 Evakuimi i emergjencës

Janë parashikuar dalje për evakuimin e mbi 0.01 persona/m². Rrugët e emergjencës janë të sinjalizuara dhe të jenë të mbrojtura ndaj zjarrit. Janë 4 shkalle emergjence ne me gjerësi rampe 1.8m. Janë 4 blloqe ashensorësh me kapacitet 15 persona. Është parashikuar dhe një nga ashensorët të jetë emergjence.

2.2.10 Ndërhyrjet e propozuara në projektin e Hotelit

Hyrja e hotelit është nga ana veriore e godinës. Ka një distance prej 17 m nga trupi i rrugës.

Kapaciteti është prej 69 dhomash dopjo.

Qarkullimi realizohet nëpërmjet 2 ashensorëve me kapacitet prej 15 personash. Nuk ka barriera arkitektonike në katin përdhe për personat me aftësi të kufizuar

Evakuimi realizohet nëpërmjet 2 shkalleve të mbrojtura nga zjarri për REI 120 minuta me gjerësi rampe 1.2m secila dhe me përmasa të shkeljeve 17x28cm

Korridoret e hotelit janë 1.5m të gjera.

Dhomat kanë sipërfaqe prej 30m² dhe janë dopio.

Kati përdhe përmban:

- Një ambient administrativ,
- Receptionin
- Lobin,
- Restorant për 48 persona.
- bar ,
- dhoma bagazhesh
- ambient stafi
- zyre administrative
- kuzhine përgatitore
- ashensor të vogël pjatash
- tualete: 2 meshkuj, 3 femra, një për PAK.
- 5 dhoma dopjo

Kati nëntokë përmban:

- Restorant për 48 persona.
- Kuzhinë
- Tualet për meshkuj dhe për femra
- Depo ushqimesh
- Lavanderi
- Depo materialesh
- Depo uji
- Dhoma teknike
- Dhoma stafi

3 KRITERET E PROJEKTIMIT

3.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

- Ligj Nr. 107/2014 Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (i ndryshuar);
- VKM Nr. 626, datë 15.07.2015 Për Miratimin e Normativave të Projektimit të Banesave
- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor.
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet në struktura.
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave të betonit.
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku.
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik.
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave për rezistencë nga tërmeti
- KTP 2-78 Kushtet Teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-89 Kushtet Teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (Norma Teknike për projektimin.

3.2 Kriteret dhe normat për durueshmërinë ndaj zjarrit të strukturës:

- Objektet e parkimit duhet të ndërtohen me strukturë të vazhduar dhe materiale jo të djegshme të tipit R90.
- Ndarje të tjera të të njëjtit objekt duhet të jenë gjithashtu të tipit R90 Komunikimi:
- Pasazhet, ashensorët dhe shkallët duhet të jenë ose të jashtme ose të ndara me kafazë me strukturë jo të djegshme të tipit Rei 120 të mbyllura me dyer antizjarr të tipit Rei 120 me vetmbyllje me vakum.
- Për lartësi të strukturës mbi 32 m nevojitet të pajisen njësitë e evakuimit dhe komunikimit vertikal me filtër ajri,
- Për lartësi më të ulët se 32m nevojitet vetëm të jenë të mbrojtura nga zjarri.

3.3 Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

3.3.1 Themelet

Për ndërtimin e një objekti të ri është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike që përcaktojnë terrenin ku parashikohet të ngrihet objektet në fjalë.

3.3.2 Konstruksioni b/a dhe muratura

Ndërtimi do të jetë prej skeleti beton-arme dhe muraturë, të kombinuara me struktura sizmike për projektimet strukturore, me soleta betoni. Është detyrë e konsulentit të zbatojë Kushtet Teknike të Projektimit shqiptar, specifike për objektin në fjalë, si dhe standardet e miratuara, lidhur me materialet që do të përdoren.

3.3.3 Tarraca dhe hidroizolimi i saj

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e tarracës, vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukëve vertikale - horizontale. Në projektimin e ullukëve duhet të merret në konsideratë që të mos bllokohen nga faktorët e jashtëm. Në tarracë duhet të evidentohen problematikat e filtrimit të ujërave dhe izolimit dhe të parashikohet aftësia e saj mbajtëse.

3.3.4 Suvatimet dhe lyerja e mureve

Objekti duhet të suvatohet nga brenda dhe nga jashtë. Muret dhe tavanet do të lyhen me bojë hidromat, ndërsa ngjyra e tyre do të vendoset në bashkëpunim me stafin e Bashkisë.

3.3.5 Fasada

Fasada të jetë e tillë, që të mirëmbahet lehtë, duhet të vishet me sistem kapot anti zjarr. Veshje me polisterol deri në 5cm me ngjitje me kolle dhe upa plastike 5 cope/1m2 dhe suvatim me grafiato akrilike.

3.3.6 Shtresat e pllakave

Të shtrohet dyshemeja me pllaka shtrim dhe veshje gres-porcelanat me permasa deri në 60x60cm. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

3.3.7 Dyert dhe dritaret

Projektuesi duhet të përcaktojë me detaje vendosjen e dyerve dhe dritareve. Dyert e jashtme duhet të parashikohen të blinduara, sipas standardeve në fuqi, dyert e brendshme me material MDF, dritare të përzgjidhen të tilla që të sigurojnë efikasitetin termik, si dhe të parashikohet vendosja e grilave.

3.3.8 Ambientet sanitare

Tualetet duhet të parashikohen me ajrosje natyrore. Të parashikohet hidroizolimi i tyre, shtrimi dhe veshja me pllaka, instalimi i të gjitha pajisjeve H/S, WC, bide, lavaman, pllakë dushi, bolier.

3.3.9 Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh kërkesat si më poshtë:

Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona.

Drejtimi i zhvillimit urbanistik i zonës do të merret në Bashki.

Për orientim, sasi të ujërave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Tiranës të përdorura për projektimin e rrjetit të kanalizimeve janë si më poshtë:

$Q_{mes\ dit} = 194\ l/ditë/banorë$

$Q_{max\ or} = 437\ l/ditë/banorë$

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e banorëve, stafit administrativ.

Rrjeti i shkarkimit të ujërave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standardet në fuqi.

Materiale plastike nuk do të përdoren në projekt si: kanal kullimi, ulluk shiu, tubacion, pjesët e brendëshme të WC-ve, etj, përveç se në rastet kur rekomandohet nga konsulenti se është materiali më i mirë që mund të përdoret për këtë qëllim. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujësjellës-Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjellësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjellës –Kanalizime sh.a Tiranë deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre me të paktën dy prej lavamaneve dhe sanitareve (wc) si dhe depozitat e ujit për MKZ. 17

3.3.10 Sistemi elektrik i ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë

Konsulenti duhet të parashikojë instalimet përkatëse për ndriçimin e dhomave me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik të objektit që të sigurojë funksionim normal të sistemit, referuar me pajisjet elektroshtëpiake që do të përdoren.

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin e parë, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit. Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni.

3.3.10.1 Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Godina duhet patjetër të ketë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjendet në një zonë me shkarkime atmosferike të shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

3.3.11 Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standardeve Evropiane.

3.3.12 Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekt të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë. Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa. Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë e i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

3.3.13 Bombolat fikëse të zjarrit

Bombolat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

3.3.14 Shkallët e emergjencës.

Konsulenti duhet të parashikojë edhe shkallët e emergjencës sipas standardeve në fuqi. Ato duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

3.3.15 Ambienti teknik.

Konsulenti duhet të parashikojë ambientin teknik në katin -1, për instalimin e sistemit të pompave dhe rezervuarët të ujit dhe numrit të tyre të llogaritur në varësi të numrit të vizitorëve në këtë objekt si dhe montim i impiantit qendror të depozitimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm të objektit sipas specifikimeve të projektuesit.

3.3.16 Sistemi i Kondicionimit

Konsulenti duhet të parashikojë instalimin e linjave të sistemit të kondicionimit dhe instalimi i pajisjeve do të bëhet nga vetë përdoruesit e godinës. Sistemi duhet të parashikohet Multisplit, me 1 njësi në fasadë të objektit dhe me disa pajisje të brendshme.

3.3.17 Muret ndarëse të brendshme

Muret e brendshme të specifikuara sipas projektuesit, ku të jenë të parashikuara shtresat e nevojshme si dhe shtresa zë-izoluese për mos depërtimin e zhurmave nga njëra njësi banimi në tjetrën.

3.3.18 Hapësira e katit -1, Parkimi Nëntokësor.

Në katin -1, duhet ta parashikohet hapësirë për parkimin e automjeteve që i shërbejnë banorëve të pallatit. Kjo hapësirë do të jetë e ndarë me poste parkimi, me skemën e qarkullimit dhe hyrje daljes në parkim, e pajisur me sinjalistikën e nevojshme të funksionimit sipas standardeve në fuqi. Gjithashtu në hapësirën e parkimit nëntokësor duhet të parashikohet ventilimi sipas standardeve në fuqi.

3.3.19 Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Projektuesi duhet t'i kushtojë një rëndësi e veçantë sistemimit të ambientit përreth. Ambientet e jashtme, janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje, sidomos si ambiente loje për fëmijët.

Rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta me pemë si dhe ndriçimi i jashtëm LED. Për të mbajtur pastërtinë duhet të vendosen kosha për mbeturinat në oborr. T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujërave sipërfaqësore.



FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT

Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qëndrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)

Raporti teknik i sistemeve elektrike, elektronike dhe informatike

Shtator, 2024

KONSULENTI:



Porositësi:	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Konsulentit:	Illyrian Consulting Engineers sh.p.k.
Objekti:	Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)
Titulli i Dokumentit:	Raporti teknik i sistemeve elektrike, elektronike dhe informatike
Faza e Projektit:	Projekt Teknik
Kodi i dokumentit:	ICE-360-P07-V01

Rish.	Qëllimi i Lëshimit	Shënime/Përshkrimi	Datë
00	Për Leje		2024

	PROJKETUES			AUTORITETI KONTRAKTUES	
	Përgatiti:	Kontrolloi:	Miratoi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri / Firma:	ICE		Olset Haxhiu		
Datë:	Shtator 2024	Shtator 2024	Shtator 2024		
Subjekti Departamenti	ICE	ICE	ICE		
Statusi i Dokumentit	Final	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

Tiranë 2024

Copyright © Illyrian Consulting Engineers

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara përveç nëse është përmendur ndryshe në marrëveshje të përbashkët. Ky dokument ose pjesë të tij nuk mund të kopjohet ose riprodhohet pa leje nga "Illyrian Consulting Engineers"

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	i
Lista e Tabelave	ii
Lista e Figurave	iii
1 Hyrje	4
2 Kriteret e përgjithshme të zgjedhjes së impianteve elektrike	5
2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike	5
3 SISTEMET ELEKTRIKE TË FUQISË	7
3.1 TE PERGJITHSHME	7
3.2 Metodologjia e llogaritjes dhe arkitektura e rrjetit elektrik	7
3.3 KABLLOT E FUQISË	7
3.3.1 Zgjedhja e kabllave bazuar në kapacitetin maksimal mbajtës të rrymës.....	8
3.3.2 Përzgjedhja e kabllave bazuar në rritjen e temperaturës nga lidhja e shkurtër.....	9
3.3.3 Zgjedhja e kabllave bazuar në rënien e tensionit	10
3.3.4 Sistemi i tokëzimit dhe mbrotjes atmosferike	11
4 SISTEMET E KOMUNIKIMIT, MBROTJES NGA ZJARRI, MENAXHIMIT DHE EVAKUIMIT	14
4.1 Sistemi i komunikimit dhe TV.....	14
4.1.1 Sistemi i komunikimit	14
4.1.2 Sistemi i TV.....	14
4.2 sistemi i mbrotjes nga zjarri dhe evakuimit zanor	15
4.2.1 Sistemi i mbrotjes nga zjarri.....	15
4.2.2 Sistemi i evakuimit zanor	16
4.3 sistemi i menaxhimit të hotelit dhe parkimit	16
4.3.1 Sistemi i menaxhimit të hotelit	16
4.3.2 Sistemi parkimit.....	17

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1 Konstantet e materialeve përcjellëse	10
Tabela 2-2 Temperatura maksimale dhe punës në përcjellës	10

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1: Vendndodhja e objektit	4
Figura 2-1 Skema tipik e funksionimit te sistemit te tokezimit.....	13
Figura 4-1 Diagrama tipike e shperndarjes se rrhetit te komunikimit.....	14
Figura 4-2 Diagrama tipike e sistemit TV	15
Figura 4-3 Diagrama tipike e sistemit te mbrojtjes nga zjarri	15
Figura 4-4 Diagrama tipike e sistemit te evakuimit zanor.....	16
Figura 4-5 Diagrama tipike e sistemit te menaxhimit te hotelit nepermjet BMS dhe KNX	17
Figura 4-6 Diagrama tipike e sistemit te menaxhimit te parkimit	17

1 HYRJE

Shoqëria "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k. në cilësinë e Konsulentit ka nënshkruar me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) në cilësinë e Zhvilluesit, kontratën me objekt: Projekti teknik për "Ndërtimi i Godinës së Parkimit Multifunksional me Shumë Nivele në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (QSUT)".

Raporti paraqet projektimin e sistemeve elektrike dhe sistemeve ndihmëse të projektit të ndërtesave të parkimit të automjeteve dhe hotelit të cilat ndodhen siç tregohet më poshtë (në kuadratin me të verdhë):




Figura 1-1: Vendndodhja e objektit

Projekti përbëhet nga dy ndërtesa me pesë kate mbi tokë dhe një kat nëntokë. Ndërtesa e parë do të shërbejë si parkim për automjetet me një volum 5 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë. Kjo ndërtesë do të lidhet me ndërtesën e re të mjekësisë së përgjithshme dhe ndërtesën kryesore të urgjencës. Ndërtesa e parkimit pozicionohet në hyrjen kryesore të QSUT-së, në perëndim të ndërtesës ekzistuese të urgjencës. Ndërtesa e dytë do të jetë hotel dhe pozicionohet në veri të ndërtesës së parkimit e ndarë me një fugë 15 cm. Kjo ndërtesë ka 5 kate mbi tokë për shërbimet e pritjes dhe të logjistikës dhe 1 kat nëntokë që do të shërbejë për ambiente teknike në funksion të hotelit.

2 KRITERET E PERGJITHSHME TË ZGJEDHJES SË IMPIANTEVE ELEKTRIKE

Ne menyre qe te kuptohet sa me thjeshte zgjedhja impiantistike e aplikuar ne projektet elektrike, ne vazhdim jane paraqitur kriteret kryesore te pershtatura ne projekt. Zgjidhja e pergjithshme ne projektet elektrike eshte mbeshtetur ne arritjen e nje sistemi teknik dhe teknologjik te pergjithshem me efikasitet te larte, duke pershtatur arkitekturen e objektit, duke respektuar normat teknike, duke siguruar konsumet energjitike minimale si dhe duke respektuar normat e ndotjes mjedisore.

Ne vazhdim po paraqesim kriteret kryesore baze te aplikuar ne projekt:

- Rehati ne perdorim
- Besueshmeri
- Inspektim te parametrave dhe impianteve
- Siguri në instalim, perdorim dhe mirembajtje
- Kursim energjie
- Respektimi i normave te ndotjes mjedisore
- Kosto te ulta ne ndertim, perdorim dhe mirembajtje

Projektet e impianteve elektrike janë mbështetur në normat teknike kombetare dhe nderkombetare EN, IEC dhe IEEE.

2.1 KODET, STANDARDET DHE DOKUMENTET TEKNIKE

- CEI 0-2: Udhëzues për përcaktimin e dokumentacionit
- CEI 11-35: Udhëzues për ekzekutimin e kabinave elektrike
- CEI 11-25: Rrymat e lidhjes së shkurtër, në sistemet trefazore alternative dhe llogaritjet e tyre
- CEI 11-26: Rrymat e lidhjes së shkurtër, llogaritja e efekteve. Definicione dhe metoda e llogaritjeve.
- IEC/EN60076-11:2004–Transformatorët e fuqisë– Pjesa11: Transformatorë të tipit të thatë;
- Rregullorja Europiane (EU) No 548/2014 te 21 Majit 2014 për zbatimin e direktivës 2009/125/EC të Parlamentit Europian dhe të Keshillit në lidhje me transformatorët e vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj të fuqisë.
- EN 50588-1 :2015 Transformatorë të mesëm të fuqisë 50Hz, me tension më të lartë për pajisjet që nuk e tejkalojnë 36kV – Pjesa 1;
- IEC/EN 60076-1:2011 Transformatorët e fuqisë– Pjesa1: I përgjithshëm;
- EN 60529 :1991 Shkallët e mbrojtjes të siguruar nga mbylljet (Kode IP);
- IEC 60.364: Ngritja e instalimit në tension të ulët
- EN 50.085: Sistemet e kanaleve të kablove sistemet e kanalave të kablove për instalimet elektrike
- EN 50.086: Sistemet e përcjellesave për menaxhimin e kablove
- EN 50.102: Shkallët e mbrojtjes të ofruara nga mbyllja për pajisjet elektrike ndaj ndikimit të jashtëm mekanik
- EN 50.298: Rrethimi bosh për automatet e tensionit të ulët dhe të kontrollit te izolimit
- CEI 60 227: Kabllot me izolim PVC dhe prcjellesit per tension nominal deri ne 450/750V
- EN 50.334: Shënimi nga mbishkrimi për identifikimin e bërthames së kablove elektrike
- EN 60.309: Priza, kutitë e prizave dhe bokset për qëllime industriale
- EN 60.423: Përcjellës për qëllime elektrike
- EN 60529: Shkallët e mbrojtjes (kodi IP)
- EN 60.865: Llogaritja e efekteve për rrymat në qark të shkurtër

- EN 60.947: Automatet e tensionit të ulët dhe kontrolli i tyre
- EN 61.537: Sistemet kanalinave të kablllove dhe sistemet për menaxhimin e kablllove
- EN 61.543: Pajisjet mbrojtëse (RCD)
- EN 61.000: Përputhshmëria elektromagnetike (EMC)
- EN 60.309.1: Priza për përdorim industrial – Pjesa 1: Rregullat e përgjithshme
- EN 60.309.2: Priza për përdorim industrial – Pjesa 2: Rregullat dimensionale të ndryshueshme
- EN 60.669: Çelësat për shtëpitë dhe instalime të ngjashme elektrike fikse
- UNI EN 12464-I: Sistemet e ndriçimit të brendshëm, të posteve të punës.
- EN 60598 : Ndriçuesit
- EN 60598.2.22: Ndriçuesit për ndriçim emergjent, Rekomandimet IES.
- UNI EN 1838: Pajisjet e ndriçimit, Ndriçimi i emergjencës.
- EN 50172: Sistemet ndriçuese emergjente të shpëtimit
- EN 60849 (CEI 100-55) – sistemi zanor
- EN 50174 klasa E – rregullore për kabllimet IT
- CEI EN 50173-1: Teknologjia e informacionit- Sistemet e kabllimit te brendshme
- CEI 103-1/1 a 103.1/16: Impiantet telefonike te brendshme
- IEC 1024 : Mbrojtja e strukturave kundrejt shkarkimeve atmosferike - Pjesa 1: Parimet e përgjithshme
- IEC 60364: Zhvillimi i instalimeve në tension të ulët
- CEI 81-10/1-4: Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike (rrufe)
- EN 50310: Aplikimi i lidhjes ekuipotenciale dhe tokëzimi në ndërtesa

3 SISTEMET ELEKTRIKE TË FUQISË

3.1 TE PERGJITHSHME

Sistemet elektrike te fuqise jane percaktuar sipas standardeve kombetare dhe nderkombetare EN dhe IEC te projektimit.

3.2 METODOLOGJIA E LLOGARITJES DHE ARKITEKTURA E RRJETIT ELEKTRIK

Rrjeti elektrik i fuqise ndahet ne dy kategori kryesore, grupi i tensionit te mesem (TM) dhe tensionit te ulet (TU). Kategoria e pare perfshin linjen e furnizimit me energji elektrike ne tension te mesem, kjo linje eshte ne pronese te kompanise shtetore OSHEE; me pas eshte nenstacioni elektrik i brendshem (kabina elektrike) me tension 20/0.4 kV, e cila perfshin çelat e tensionit te mesem, transformatorin dhe kuadrot e tensionit te ulet, se bashku me elementet ndihmes dhe kabllin e tensionit te mesem dhe te ulet. Secilet nga kuadrot e tensionit te mesem dhe te ulet perfshin pajisjet e komutimit, mbrojtjes dhe sinjalizimit.

Te dy ndertesat kane te njejten kabine elektrike dhe eshte e instaluar ne katin perdhe te parkingut, secila ndertese furnizohet nga kuadri elektrike kryesor i tensionit te ulet. Gjithashtu, secili mjedis kryesor apo kat i hotelit apo parkingut kane kuadrin elektrik te tyre, te cilet furnizojne ngarkesat perkatese.

Llogaritja e sistemit elektrik ne lidhje me fuqine e instaluar dhe kerkuar eshte realizuar duke i referuar standerdeve EN dhe IEC, koeficientet e njekohshmerise dhe perdorimit dhe si perfundim fuqia e instaluar e transformatoreve eshte 400 kVA dhe 500 kVA. Gjeneratori eshte eshte pjese e kabines elektrike qe do te sherbeje si rezerve ne rast nderprerje te rrjetit kryesor, fuqia e instaluar e gjeneratorit eshte 70 kVA, i tipit me nafte. Po ashtu, edhe UPS me fuqi te instaluar 15 kVA dhe autoonomi 15 min eshte perdorur per ngarkesat e kategorise se pare, te cilat nuk duhet te kene nderprerje te energjise ne asnje moment te kohes.

3.3 KABLLOT E FUQISË

Në llogaritjen e rënies së tensionit, u morën parasysh rezistenca dhe reaktanca e secilit segment kabllor dhe ngarkesa që kalon nëpër atë segment kabllor. Vlerat e rënies së tensionit në çdo skaj të linjës/degës llogariten si rezultat i shumës së rënieve të tensionit të secilit segment nga burimi deri në fund të linjës/degës.

Për të përmasuar saktë kabllot e rrjetit TM dhe TU bazuar në standardet elektrike, duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

- Kriteri i kapacitetit mbajtës të rrymës: Rryma e punës korrigjohet në bazë të karakteristikave të instalimit dhe vendndodhjes. Kjo vlerë e korrigjuar duhet të jetë më e ulët se kapaciteti maksimal i rrymës që mund të përballojë kabloja. Këto vlera maksimale të kapacitetit mbajtës të rrymës bazohen në tabela standard;
- Kriteri i rritjes së temperaturës së qarkut të shkurtër: Rryma e lidhjes së shkurtër duhet të jetë më e ulët se kufiri i mbështetur nga kabloja;
- Kriteri i rënies së tensionit: Kriteri i rënies së tensionit përcakton se rënia e tensionit në çdo kablo duhet të jetë më e ulët se vlera maksimale e lejuar, e përcaktuar në dokumentin bazë të projektimit – 3 % per sistemet elektronike dhe 5 % per sistemet elektrike te fuqise. Megjithëse ky kriter merret parasysh kur vlerësohet madhësia e kabllit të energjisë, mospërputhja me këtë kusht nuk nënkupton që linja kabllore do të dëmtohet; në vend të kësaj, kjo do të thotë se humbjet do të jenë më të larta.

Gjithashtu, kufizimet e mëposhtme merren parasysh gjatë llogaritjes së tensionit të ulët (LV).

- Të përdoren seksionin(et) e kablllove optimale për të minimizuar kostot dhe për të garantuar kriteret teknike sipas standardeve të përmendura më sipër dhe kodeve përkatëse
- Bakri propozohet si një material përcjellës për kabllot LV

Supozimet e bëra gjatë përcaktimit të madhësisë dhe vlerësimit të kablllove janë si më poshtë: Temperatura e tokës është e barabartë me 20°C nëse nuk ka informacion.

- Temperatura e mjedisit është temperatura maksimale historike e regjistruar në vendndodhjen e projekti (e marrë nga stacionet meteorogjike)
- Rezistenca e tokës është e barabartë me 1 K·m/W nëse nuk ka informacion të disponueshëm
- Thellësia e vendosjes së kablllove nën tokë është 80 cm
- Tubat e brinjëzuar me kablllo brenda do të vendosen nën nivelin e tokës në korsinë e biçikletave ose në korsinë e trotuarit, siç tregohet në vizatimet përkatëse.

Seksionet në vijim do të paraqesin metodologjinë e llogaritjes dhe llogaritjet për kapacitetin maksimal të rrymës, rritjen e temperaturës së qarkut të shkurtër dhe rënien e tensionit të sistemit të ndriçimit TU.

3.3.1 Zgjedhja e kablllove bazuar në kapacitetin maksimal mbajtës të rrymës

Kapaciteti mbajtës i rrymës është rryma maksimale që mund të rrjedhë nëpër një përcjellës elektrik pa e dëmtuar atë. Kjo vlerë ndryshon në varësi të përcjellësit, kushteve mjedisore, seksionit tërthor, materialit izolues dhe numrit të përçuesve të grupuar.

Rryma e funksionimit korrigjohet në bazë të karakteristikave të ndryshme të instalimit dhe vendit. Kjo vlerë rryme e korrigjuar duhet të jetë më e ulët se kapaciteti maksimal i rrymës që mund të përballojë kabllin. Ekuacioni për rrymën e lejuar të korrigjuar jepet nga ekuacioni i mëposhtëm.

$$I_{Llogaritjes} \leq I_{ccc}$$

- $I_{Llogaritjes}$ - paraqet rrymën e llogaritjes për kushtet e përcaktuara të instalimit [A].
- I_{ccc} – paraqet kapacitetin e rrymën maksimale të përcjellësit

Siç është paraqitur në seksionet e mëposhtme, rryma e punës së kabllit korrigjohet me faktorët e mëposhtëm:

- Një faktor korrigjimi i temperaturës së ajrit të mjedisit zbatohet vetëm kur kabllot ekspozohen ndaj ajrit ose instalohen në kanalina të lidhura në struktura.
- Faktori i korrigjimit të temperaturës së tokës zbatohet vetëm kur kabllot vendosen drejtpërdrejt në kanale ose në tuba të vendosura nëntokë.
- Faktori i korrigjimit të rezistencës së tokës zbatohet vetëm kur kabllot vendosen drejtpërdrejt në kanale ose në tuba të vendosura nëntokë.
- Ne konsiderojmë se faktori i korrigjimit të thellësisë së vendosjes zbatohet vetëm kur kabllot instalohen drejtpërdrejt në kanale ose në tuba të vendosura nëntokë.
- Grupimi i kablllove së bashku çon në ngrohjen shtesë të kablllove, gjë që rrit humbjet dhe ul aftësinë mbajtëse të rrymës.

Ekuacioni i mëposhtëm jep madhësinë e rrymën bazuar në standardin IEC 60364-5-52].

$$I_{Llogaritjes} = \frac{I_{Punës}}{CF}$$

Ku:

$I_{Llogaritjes}$ - paraqet rrymën e llogaritjes për kushtet e përcaktuara të instalimit [A].

$I_{Punës}$ - paraqet rrymën e punës së ngarkesës [A]

CF është produkt i të gjithë faktorëve korrigjues të aplikuar.

3.3.2 Përzgjedhja e kablove bazuar në rritjen e temperaturës nga lidhja e shkurtër

Kur ndodh një qark i shkurtër, rryma që rrjedh nëpër përcjellës mund të kalojë rrymën nominale gjatë periudhave të shkurtra, duke ngrohur ose nxehur izoluesin e përcjellësit. Kështu, është e nevojshme të verifikohet nëse seksioni tërthor i propozuar mund të përballojë rrymën maksimale të qarkut të shkurtër. Ekuacioni i mëposhtëm përcakton seksionin tërthor të kabllit bazuar në kriterin e mësipërm.

$$S = \frac{I_{AD} \cdot \sqrt{t}}{k} = \frac{I_{sc} \cdot \sqrt{t}}{\varepsilon \cdot k}$$

Ku:

- S - seksioni tërthor i kabullit në [mm^2];
- I_{AD} - është rryma e qarkut të shkurtër për kushtet adiabatike;
- I_{sc} - është rryma e qarkut të shkurtër. Llogaritja e plotë e kësaj rryme të qarkut të shkurtër është paraqitur në paragrafët e mëposhtëm;
- ε - është faktori i shpërndarjes së nxehjes së kablove. Për kushte adiabatike $\varepsilon = 1$;
- t - është kohëzgjatja e qarkut të shkurtër në [s]. Është e barabartë me 0.1 s;
- k - jepet nga ekuacioni i mëposhtëm.

$$k = K \sqrt{\ln \left(\frac{\theta_f + \beta}{\theta_i + \beta} \right)}$$

Ku:

- K - është një konstante që varet nga natyra e përcjellësit dhe kufiri i temperaturës së izolacionit në [$As^{0.5}/m^2$]; ky parametër është i barabartë 226 $As^{0.5}/m^2$ për bakër (Cu)
- β - koeficienti i temperaturës së rezistencës në 0 °C; ky parametër është i barabartë 234.5 °C për bakër (Cu)
- θ_f është temperatura përfundimtare e qarkut të shkurtër të përcjellësit në [°C]. Vlera e saj varet nga standardi.
- θ_i është temperatura maksimale e lejuar e përcjellësit në [°C]. Është e barabartë me temperaturën maksimale të funksionimit të izolacionit në rregjim pune normale.

Kështu, seksioni tërthor i kabllit përcaktohet nëpërmjet ekuacionit të mëposhtëm.

$$S_{min} = \frac{I_{sc} \cdot \sqrt{t}}{K \sqrt{\ln\left(\frac{\theta_f + \beta}{\theta_i + \beta}\right)}}$$

K është një konstante që varet nga natyra e përcjellësit dhe kufiri i temperaturës së izolatorit, dhe β është koeficienti i temperaturës së rezistencës në 0 °C, siç tregohet në tabelat e mëposhtme.

Tabela 2-1 Konstantet e materialeve përcjellëse

Materiali përcjellës	$K [As^{0.5}/m^2]$	$\beta [^{\circ}C]$
Bakër	226	234.5
Alumin	148	228

Bazuar në standardin IEC, temperatura e përcjellësit gjatë rregjimeve të ndryshme të punës tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2-2 Temperatura maksimale dhe punës në përcjellës

Temp. maksimale e përcjellësit [$^{\circ}C$]	XLPE	EPR
Në rregjim pune normale, θ_i	90	90
Në rregjim pune të lidhjes së shkurtër, θ_f	250	250

3.3.3 Zgjedhja e kabllove bazuar në rënien e tensionit

Kufizimet e rënies së tensionit imponojnë përdorimin e seksioneve më të mëdha të kabllove. Megjithatë, nëse ky kriter nuk plotësohet, rezulton në humbje më të mëdha. Ekuacionet e mëposhtme përdoren për të llogaritur seksionin tërthor të kablrit që respekton kufirin e rënies së tensionit të zgjedhur nga përdoruesi. Këto ekuacione ndryshojnë pak në varësi të llojit të rrymës që kalon nëpër kablo.

Llogaritjet e rënies së tensionit do të bazohen në IEC 60364-5-54 dhe IEC 60364-5-52 për instalimet me tension të ulët. Sipas standardeve të mësipërme, formula e rënies së tensionit për qarqet AC është si më poshtë.

$$\Delta V_d(\%) = \sqrt{3} \cdot I \cdot (R \cdot \cos \varphi + X \cdot \sin \varphi) \cdot L \cdot \frac{100}{n \cdot V}$$

Për më tepër, llogaritja jepet nga ekuacioni i mëposhtëm: sipërfaqja minimale e seksionit tërthor për një rënie të caktuar të tensionit (në këtë projekt, konsiderohet jo më shumë se 3 %).

$$S_{min} = \frac{\rho(\theta_i) \cdot \cos \varphi}{n \cdot \left(\frac{\Delta V \cdot V}{\sqrt{3} \cdot I \cdot L} - X \cdot \sin \varphi \right)}$$

Ku:

- $\cos \varphi$ është faktori i fuqisë
- n është numri i dejeve për fazë
- X - është reaktanca e një qarku të vetëm në [Ω/km]
- R - është rezistenca e një qarku të vetëm në [Ω/km]
- L - është gjatësia e kablrit në [m].
- S_{min} - është seksioni tërthor minimal (mm^2)

- $\rho(90)$ - rezistenca e kabllit në temperaturën maksimale të punës normale (90 °C)
- I - është rryma e punës që kalon përmes kabllit në [A].
- $\Delta V_d(\%)$ - është rënia e tensionit (%)
- θ_i temperatura maksimale e lejuar e funksionimit të kabllit gjatë rregjimit normal
- I - vlera e tensionit [V].

Rezistenca e materialit përcjellës në një temperaturë specifike llogaritet duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm.

$$\rho(\theta_i) = \rho(20^\circ\text{C}) \cdot (1 + \alpha(\theta_i - 20))$$

Ku,

- $\rho(\theta_i)$ - është rezistenca e materialit përcjellës në θ_i (°C) in [$\Omega\text{m}^2/\text{m}$]
- $\rho(20^\circ\text{C})$ - është rezistenca e materialit përcjellës në 20 °C in [$\Omega\text{m}^2/\text{m}$].
- α - është parametër që varet nga lloji i materialit të përdorur.

Bazuar në kriteret e përcaktuara në bazën e projektimit, rënia e lejuar e tensionit duhet të jetë më e vogël se 3 % ose 5% ne varesi te sistemit për kabllon XLPE, PVC ose EPR të përzgjedhur me prerje tërthore të caktuar.

3.3.4 Sistemi i tokëzimit dhe mbrotjes atmosferike

Projektimi i sistemit te tokezimit eshte bazuar normativat kombetare dhe nderkombetare EN, IEC dhe IEEE te projektimit. Sistemi I tokezimit te ndertesese se hotelit do te jete I perbashket me sistemin e tokezimit te ndertesese se parkingut. Gjithaashtu, tokezimi I rrjetit te fuqise do te jete I perbashket me sistemin e tokezimit te rrufepritesve. Sa I perket tokezimit te ndricimit, do te realizohet me nje shirit 30x3 mm te vendosur 50 cm ne thellesi, te shtrire ne kanal.

3.3.4.1 Metodologjia e llogaritjeve te rezistences se tokezimit

Për llogaritjen e tokëzimit do të bazohemi në standartet e IEEE referuar te çështjeve te meposhtme:

- Rezistenca specifike e tokës (Ωm)
- Thellësia e vendosjes së elektrodave (m)
- Gjatësia e elektrodave (m)
- Materiali hekur I galvanizuar ne te nxehte

Për llogaritjen e seksionit të përcjellësave që do përdorim për tokëzim do të përdorim formulën:

$$Amm^2 = \frac{I}{\sqrt{\left(\frac{TCAP \times 10^{-4}}{t_c \alpha_r \rho_r}\right) \ln\left(\frac{K_0 + T_m}{K_0 + T_a}\right)}}$$

ρ_r -Përcjellshmëria e materialit

T_m - Temperatura maksimale e lejuar në °C

T_h – Koeficienti termik referuar temperatures T_r në 1/°C

T_a - Temperatura e ambjentit në °C

$K_0 -1/\alpha_0$ ose $1/\alpha_r - T_r$ në °C

- l – Rryma e lidhjes së shkurtër (l.sh.) në kA
- tc- Kohëzgjatja e Rrymës në s
- TCAP- Kapaciteti Termik për njësi të volumit
- Amm2- Sipërfaqja e përcjellësit në mm²

Për llogaritjen e rezistencave të tokëzimit do të përdorim formulat:

Për rrjetën:

$$R_m = \frac{\rho}{4} \left(\sqrt{\frac{\pi}{A}} + \frac{4}{L} \right)$$

Ku :

P - është rezistenca specifike e tokës

A - është sipërfaqja e rrjetës dhe

L - gjatësia e përcjellësave të tokëzimit të rrjetës

Për rezistencën e tokëzimit për një elektrodë do të përdorim formulën:

$$R_{ip} = \frac{\rho}{2\pi \cdot L} \left(\ln \frac{4L}{r} - 1 \right)$$

Ku:

L - është gjatësia e elektrodës

r- rrezja ekuivalente e elektrodës

Për përcjellësat horizontalë do të përdorim formulën:

$$R_c = \frac{\rho}{\pi L} \left(\ln \frac{\sqrt{2L}}{\sqrt{r \cdot h}} - 1 \right)$$

Ku:

L- është gjatësia totale e përcjellësit

r- rrezja ekuivalente

h- thellësia e vendosjes.

Numri total i elektrodave

Gjithashtu është menduar që në katin e parkingut dhe katin zero, struktura metalike e objektit do të lidhet me përcjellës Fe/ZN me morseta duke formuar rrjete ekuipotenciale.

3.3.4.2 Rezistenca e Tokëzimit të rrjetit të Ndrëçimit Rrugor

Tokëzimi i shtyllave të ndriçimit do të bëhet nëpërmjet elektrodës horizontale FeZn Ø10mm, e cila do të shtrihet përgjatë kanalit poshtë vijës së furnizimit të shtyllave. Kjo zgjidhje, në krahasim me një shufër tokëzimi vertikale individuale për çdo shtyllë, do të bëjë të mundur arritjen e një rezistence më të ulët të tokëzimit, të jetë më e sigurt në skenarë specifikë dhe të ketë një kosto më të ulët zbatimi.

Është përdorur formula standarde EN 50522 "Annex J" për llogaritjen e rezistencës së tokëzimit, e cila i referohet vlerësimit të rezistencës së elektrodës së tokëzimit të shiritit.

Do të merret në konsideratë skenari më i keq, me një gjatësi prej rreth 300 ml të shufrës së tokëzimit. Të gjitha linjat e tjera (shufrat e tokëzimit) do të jenë më të gjata dhe do të kenë rezistencë më të ulët të tokëzimit.

Gjithashtu, si rezistencë ndaj tokës, do të konsiderojmë një vlerë prej 500 Ωm . Në realitet, ne presim një vlerë më të ulët pasi dhe në qytetin e Durrësit në 0.75 m thellësi është zakonisht i lagësht dhe uji i infiltruar në vend ka një përqindje të lartë të kripërave.

$$R(EB) = \frac{\rho E}{2\pi L} \ln \frac{4L}{d}$$

Ku:

$R(EB)$ - Rezistenca e tokëzimit me shirit përcjellës

ρE - Rezistenca e tokës (500 Ωm)

L - Gjatësia e rripit (shiritit) (300 m)

d - Gjysma e gjerësisë së shiritit (0.005 m)

$$R(EB) = 6.21 \Omega$$

Kjo rezistencë tokëzimi bën të mundur përdorimin e releve diferenciale me $I_{dn} = 0.3$ A pasi $I_{dn} \cdot R(EB) = 1.86$ V, më i vogël se tensioni alternativ i lejuar i prekjes prej 50 V..

Sistemi i tokëzimit për këtë rrjet elektrik duhet të jetë TT, siç tregohet në figurën e mëposhtme.




Figura 2-1 Skema tipik e funksionimit të sistemit të tokëzimit

3.3.4.3 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike

Për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike do të përdorim metodën e sferave rrufeprites ESE. Duke qene se ky objekt është më i lartë se objektet e tjera, mundësia që të preket nga shkarkimet atmosferike është më e madhe.

Rrjeta do të realizohet me përcjellës Fe/Zn 30x3 ndërsa shtizat do të jenë të prodhimit standart me gjatësi 2 m dhe në kreun e shtizes do të instalohet rrufepritesi ESE. Këto rrufeprites janë instaluar në muret anësore të ndërtesës. Objekti është klasifikuar i klasës IV dhe rezulton se në baze të gjeometrise së ndërtesës, numri optimal i rrufepritesve ESE është gjashtë. Për përcjellësat zbritës do të përdorim shirit Fe/Zn 30x3 mm.

Sistemi i tokëzimit duhet të jetë i tillë që të shpërndajë dhe eliminojë energjinë e shkarkimeve që vjen nga përcjellësat zbritës. Ai duhet të minimizojë brenda vlerave të lejuara tensionin e prekjes dhe atë të hapit. Ai duhet të garantojë një punë normale pa krijuar problem në njerëz dhe paisje.

Për sistemin e tokëzimit të sistemit rrufeprites do të përdorim të njëjtin sistem tokëzimi që kemi përdorur për tokëzimin e punës.

Rezistenca e tokëzimit duhet të jetë jo më shumë se 4 Ω (ohm) në periudhën më të thatë të vitit.

4 SISTEMET E KOMUNIKIMIT, MBROTJES NGA ZJARRI, MENAXHIMIT DHE EVAKUIMIT

Keto sisteme, vecanerisht pajisjet qendrore, lokale dhe kabllimi duhet jene te projektuara dhe prodhuara ne perputhje me standardet vendase dhe nderkombetare EN, IEC, IEEE, ISA dhe iso.

4.1 SISTEMI I KOMUKIMIT DHE TV

4.1.1 Sistemi i komunikimit

Ky sistem do te jete i perbere nga disa pajisje dhe materiale ndihmese te cilat realizojne teresine dhe funksionimin e tij. Pjesete perberese te tij jane:

Sisteme i internetit, i cili eshte i perbere nga nje server qendror i cili menaxhon dhe kontrollon trafikun e sinjaleve ne sistemet e ndertesave se hotelit dhe parkingut; gjithashtu, pjese e tij jane switchet (çelesat elektronik), routeri qendror dhe lokal te shperndare ne mjedise te ndryshme te ndertesave. Keto pajisje jane pjesa qendrore e menaxhimit, kontrollit dhe mbrojtjes se informacionit qe rrejdh ne linjat e komunikimit. Pervec ketyre pajisjeve, pjese e sistemit jane edhe kabllo e komunikimit LAN dhe prizat e internetit te instaluar ne vendet perkatese, shih vizatimet perkatese.




Figura 4-1 Diagrama tipike e shperndarjes se rrhetit te komunikimit

4.1.2 Sistemi i TV

Sistemi i televizionit do te jete i perbere nga pajisjet qendrore te komandimit dhe menaxhimit, pasjisjet okale dhe kabllimi. Skema tipike e realizimit te sistemit te televizionit eshte si ne vijim.




Figura 4-2 Diagrama tipike e sistemit TV

4.2 SISTEMI I MBROTJES NGA ZJARRI DHE EVAKUIMIT ZANOR

4.2.1 Sistemi i mbrojtjes nga zjarri




Figura 4-3 Diagrama tipike e sistemit te mbrojtjes nga zjarri

Ky sistem do të përbehet nga pajisjet qendrore, të cilat kanë detyrë menaxhimin dhe komandimin e sinjaleve në pajisjet lokale të instaluar në mjedise të vecanta e të ndertesave të hotelit dhe parkingut. Gjithashtu, pjesë e tyre janë edhe pajisjet lokale dhe kabllimi.

4.2.2 Sistemi i evakuimit zanor

Gjithashtu, ashtu si në sistemin e mbrojtjes nga zjarri, edhe sistemi i evakuimit zanor është i përbërë nga pajisjet qendrore, lokale dhe kabllimi. Shënojmë se ky sistem është i ndërlidhur me sistemin e mbrotjes nga zjarri dhe shenjat e evakuimit, pasi ky përdoret në raste njoftimesh të rasteve të ndryshme. Skemat tipike e një sistemi evakuimi tregohet në figurën e mëposhtme.




Figura 4-4 Diagrama tipike e sistemit të evakuimit zanor

4.3 SISTEMI I MENAXHIMIT TË HOTELIT DHE PARKIMIT

4.3.1 Sistemi i menaxhimit të hotelit

Ky sistem do të përbehet nga njësitë qendrore të komandimit dhe kontrollit, zakonisht BMS (building management system), i cili ka të integruar disa protokolle komunikimi kabllor të sinjaleve, një ndër të cilat është edhe KNX, i cili është shumë i përhapur, relativisht i sigurtë dhe fleksibel. Ky sistem do të menaxhojë aksesin në dhomat e hotelit nëpërmjet lexuesve të aksesit, mbajtësve të kartës së aksesit dhe braves elektrike. Gjithashtu, pjesë e tij do të jetë edhe menaxhimi dhe komandimi i sistemit të ngrohje-ftohjes qendrore nëpërmjet një ekrani të instaluar në secilën dhomë dhe mjedise të tjera të hotelit. Po ashtu, parandalimi i

hyrjeve te padeshiruara, informimi i te cilave behet duke instaluar sensor levizje ne cdo dritare ku mund te kete mundesi hyrje, sic jane dritaret dhe dyert. Nje diagrame tipike jepet ne figuren e meposhtme.




Figura 4-5 Diagrama tipike e sistemit te menaxhimit te hotelit nepermjet BMS dhe KNX

4.3.2 Sistemi parkimit

Ky system do te mundesoje lehtesimin ne menaxhimin e parkimit te makinave. Ky system perbehet nga njesite qendrore te menaxhimit, pajisjeve locale te instaluar ne ndertesën e parkingut sic jane sensorët e vendosur ne tavanin e secilit vend parkimi me qellim informimin e gjendjes per secilin vend (I lire, I zene, ne mirembajtje), edhe tabelat informuese per numrin e vendeve te lira ne secilin rresht, sic tregohet ne vizatimet perkatese. Me poshte, jepet edhe skema tipike e menaxhimit te sistemit te parkimit.




Figura 4-6 Diagrama tipike e sistemit te menaxhimit te parkimit

Nenvizojme se sistemi i ri i menaxhimit të parkimit do të integrohet me sistemin aktual që është në përdorim.

